



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Menaxhim Biznesi” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Wisdom”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Dr. Fatmir Memaj

2. Prof. Asoc. Dr. Arjan Qefalia

Qershor 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në Menaxhim Biznesi ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Larte Kolegji Universitar “WISDOM”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Wisdom”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhëri i MASH nr.241, datë 31/05/2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i MAS Nr.468, datë 02.10.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër i MAS datë 30.05.2016 në zbatim të VKA nr.158, datë 16.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE/1 PAK v.a. 2021-2022 13 PAE/1 PAK v.a. 2020-2021 11 PAE/2 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	110 studentë per v.a. 2019-2022
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike, në përfundim të të cilave merret diploma me profilin përkatës. Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është licensuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.128, datë 03/12/2010 dhe Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 241, datë 31/05/2011 (referuar Aneksit 2.02). Me VKM nr.254, datë 27/02/2008 u licensua si Shkollë e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom”. Me Vendimin nr.47, datë 29/06/2015 u fitua për herë të parë akreditimi institucional (si SHLUJ “Wisdom”). Me VKM nr. 672, datë 27/09/2006 Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim biznesi”, ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, njësi e vendosur në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Kolegji Universitar “Wisdom” me VKM nr.672, datë 29/07/2006 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit në përputhje me licencën e dhënë, duke filluar veprimtarinë e saj akademike qysh në fillim të vitit mësimor 2011-2012.

Kolegji Universitar “Wisdom” ka përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës” dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioriteteve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të Kolegjit Universitar “Wisdom” të përcaktuar në Statutin e Kolegjit Universitar “Wisdom” (siç cilësohet tek Aneksi 1.01 i tij).

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Kolegjit Universitar “Wisdom”. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në menaxhim, ekonomiks, financë, kontabilitet, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Menaxhimit/Administrimit, si në sektorin publik edhe atë privat.

Ky raport u përgatitur nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim biznesi”.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën një ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit Bachelor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datën 24 Shkurt 2022. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL, gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit Bachelor në “Menaxhim biznesi”. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është i atashuar pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është MSc. Muhamed Prezja.

GVJ pasi u njoh me komentet e KU WISDOM rreth Draft RVJ-së dërguar shprehet si më poshtë:

Sqarim: GVJ në hartimin e RVJ është bazuar në evidencat e dorëzuara nga IAL KUW pranë ASCAL para dhe pas vizitës fizike në IAL KUW, si dhe bazuar në vizitën dhe diskutimet & takimet e bëra në IAL KUW. Në këtë mënyrë, GVJ i qëndron mendimeve, konstatimeve dhe sugjerimeve të bëra në draft RVJ. Në mënyrë më të detajuar, qëndrimet e GVJ jepen si vijon:

Lidhur me kriterin e Standardit III.2.4: Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira ... Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit:

Komenti i GVJ: GVJ i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *Konstatohet që disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc ... sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr. Gjithashtu, në dokumentat e paraqitura CV e stafit akademik duheshin më të plota dhe më të*

unifikuara si format (psh., disa janë në gjuhën shqipe, disa në gjuhën angleze, etj). Si dhe, tek RVB, kjo pikë duhej plotësuar më plotë nga ana e grupit të punës.

Lidhur me kriterin e Standardit III.3.1: Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor ... *Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra konstatimit në periudhën kur u zhvillua vizita fizike në IAL KUW: *Sugjerohet nga GVJ që tek auditorët të mbyllet pjesa lart e mureve (janë të hapura) sepse krijon probleme/konfuzion/zhurma kur zhvillohet mësim në shumë salla njëkohësisht.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.3.5: Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor ... *Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor:*

Komenti i GVJ: GVJ i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka e IAL KUW, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave në të ardhmen për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë. Pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave fizikë për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Menaxhim biznesi. Si dhe numri i kompjuterave / laptopëve në bibliotekë është i vogël dhe sugjerohet shtimi i kompjuterave /laptopëve për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.3.8: Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor ... *Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra konstatimit në periudhën kur u zhvillua vizita fizike në IAL KUW: *Në fakt mungon një platformë standarde e-learning (sipas RVB të KUW), por IAL ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Rosetta Stone për platformë online të studimit në gjuhën angleze. Konstatohet që mungon një platformë standarde e-learning (edhe sipas RVB të KUW).*

Lidhur me kriterin e Standardit III.3.9: Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor ... *Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës në të ardhmen: pra, *në fakt sugjerohet nga GVJ që në të ardhmen GVB duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi informacionit që jep për plotësimin e kriterëve të standardeve (në rastin konkret për standardin III.3.9)*

Lidhur me kriterin e Standardit III.3.10: Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor ... *Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter (kjo nga hulumtimi i rregulloreve përkatëse të dërguara në ASCAL përpara dhe pas vizitës së bërë në IAL KUW): pra, *temat e diplomës të shpallura nga Dekanati, bëhen publike dhe studentët me notë mesatare mbi 8.5 bëjnë zgjedhjet përkatëse (mbrojnë me temë diplomë studentët që deri në semestrin e pestë kanë mesatare 8.5 e më lart ... sipas RVB të IAL KUW). GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë. Nga takimi me drejtues të IAL, u konstatua nga GVJ që deri më tani studentët që përfundojnë studimet BSc në Menaxhim Biznesi, diplomën e mbrojnë me provim të përgjithshëm.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.4.3: Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit ... *Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, pra *GVJ mendon se duhet të kishte më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.5.1: Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre ... *Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, pra: *përgjithësisht këto dokumenta janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, por GVJ sugjeron që të publikohen të gjitha dokumentat zyrtare (rregullore, etj) në faqen web të IAL KUW.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.5.2: Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre ... *Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL K UW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter (kjo nga hulumtimi i dokumentave përkatëse të dërguara në ASCAL përpara dhe pas vizitës së bërë në IAL K UW): *pra, te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), syllabuset përmbajnë informacion vetëm për pjesën/modulin e Menaxhimit strategjik & Biznesit ndërkombëtar & Informatikës (dhe nuk përmbajnë informacion për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit).*

Lidhur me kriterin e Standardit III.7.9: Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore ... *Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL K UW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter [kjo nga hulumtimi i dokumentave përkatëse (dhe vizita në IAL) të dërguara në ASCAL përpara dhe pas vizitës së bërë në IAL K UW]: *pra, ekziston një vendim i administratores, por duhej më shumë informacion mbi materializimin (aplikimin në praktikë) e vendimit të administratores për ide konkrete, inovative të studentëve, etj.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.7.10: Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore ... *Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL K UW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, pra *GVJ mendon që duhen më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.*

Lidhur me kriterin e Standardit III.8.1: Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm ... *Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL K UW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter (kjo nga hulumtimi i rregulloreve përkatëse të dërguara në ASCAL përpara dhe pas vizitës së bërë në IAL K UW): *pra, nga takimi me drejtues te IAL, u konstatua nga GVJ që deri më tani studentët që përfundojnë studimet BSc në Menaxhim*

Biznesi, diplomën e mbrojnë me provim të përgjithshëm (mbrojnë me temë diplomë studentët që deri në semestrin e pestë kanë mesatare 8.5 e më lart ... sipas RVB të IAL KUW). GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë për mbrojtjen e diplomës nga studentët me notë mesatare 8.5 e lart, si dhe që rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore është e paplotë ... mungojnë faqe (aneksi 2.06).

Lidhur me kriterin e Standardit IV.1.1: Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit ... *Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter (kjo nga hulumtimi i rregulloreve përkatëse të dërguara në ASCAL përpara dhe pas vizitës së bërë në IAL KUW): pra, *Zyra e Burimeve njerëzore është bashkë me Këshillimin e Karrierës. GVJ sugjeron që duhet të jenë në vete si dhe rregullorja e BNj është e 'thatë' dhe duhet më e zgjeruar.*

Lidhur me kriterin e Standardit IV.2.2: Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive ... *Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, *pra GVJ konstaton gjithashtu se KUW përpaket të mbështesë personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore, ku ekziston dhe një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për vitin akademik 2021-2022, por duhet theksuar që duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.*

Lidhur me kriterin e Standardit IV.4.2: Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit ... *Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit:*

Komenti i GVJ: GVJ i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *GVJ mendon se pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të*

librave në literaturën fizike për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Menaxhim biznesi.

Lidhur me kriterin e Standardit IV.6.3: Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve ... *Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare:*

Komenti i GVJ: GVJ bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL KUW i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *GVJ konstaton se në të dhënat e ngarkuara në sistem mungon një raport auditimi ligjor i pavaruar që vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të IAL, dhe ku të paraqiteshin në mënyrë të hollësishme analiza në lidhje me të ardhurat dhe kostot për studentët duke argumentuar edhe përputhjen e performancës financiare të KUW në lidhje me standardet kontabël të miratuara.*

Lidhur me kriterin e Standardit V.1.5: Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit ... *Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj:*

Komenti i GVJ: GVJ (bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL KUW para dhe pas vizitës në IAL) i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *duhet thënë që ky kriter është keqkuptuar nga GVB në përgjigjen që ka dhënë (duhej apo duhet informacion më i plotë).*

Lidhur me kriterin e Standardit V.4.4: Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm ... *Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar:*

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL KUW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, pra *GVJ konstaton që notat plotësohen manualisht nga pedagogët në procesverbalet përkatëse dhe akoma nuk ka një sistem të mirëfilltë informacioni.*

Lidhur me kriterin e Standardit V.4.5: Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm ... *Institucioni duhet*

të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve:

Komenti i GVJ: GVJ nuk i mohon përpjekjet për përmirësim të IAL K UW, por i qëndron mendimit të tij për këtë kriter, pra tabelat me të dhënat e studentëve alumni duhen më të plota, me më shumë informacion, pra duhet më shumë punë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Rrjeti Alumni duhet më i plotë, i mirëfilltë, dhe më i organizuar në aktivitetet që zhvillon IAL për përfitim të dyanshëm. jo thjesht mbajtje kontaktesh të tyre.

Lidhur me kriterin e Standardit V.5.1: Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre ... Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve:

Komenti i GVJ: GVJ (bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL K UW para dhe pas vizitës në IAL) i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: në RVB te ky kriter duhet më shumë evidencë për studentët pjesëmarrës në komisionet e përhershme apo NJSBC, pra mungojnë vendimet apo procesverbalet përkatëse.

Lidhur me kriterin e Standardit V.6.4: Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët ... Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse:

Komenti i GVJ: GVJ (bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL K UW para dhe pas vizitës në IAL) i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: ZBNJKKS nuk ka ndërtuar akoma një databazë të dhënash mbi punësimin e studentëve të programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi (sipas RVB te i njëjti kriter). Sugjerohet që të ndahen veç e veç Zyra e Burimeve Njerëzore me zyrën e Këshillimit të Karrierës & Jetës Studentore. Rregullorja e ZBNJKKS duhet të përmirësohet, është shumë e shkurtër/e 'thatë'. Duhet më shumë punë nga specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore për të krijuar të dhëna dhe kontakte më të plota (jo thjesht emër, mbiemër, numër telefoni, i punësuar apo jo ...) me studentët e diplomuar/alumni dhe për t'i vënë në funksion të përfitimit të dyfishtë: IAL K UW dhe Studentë alumni, psh. mbajtja më afër e tyre, apo të ftohen në konferenca shkencore të K UW, apo të financojnë projekte të ndryshme të pedagogëve apo studentëve, dhe aktivete të ndryshme studentore.

Lidhur me kriterin e Standardit VI.2.1: Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të

garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit ...
Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë:

Komenti i GVJ: GVJ (bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL KUW para dhe pas vizitës në IAL, si dhe bazuar në vizitën në IAL KUW) i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra: *sugjerohet që roli i NJSBC të jetë më i madh dhe më i plotë në sugjerimet që jep për departamentet (konstatim i GVJ në takimin me NJSBC). S'ka dokument bashkëngjitur për ngritjen e komisionit të kurrikulave (a funksionon ky komision). Në RVB duhej (apo duhet) më shumë informacion për Komisionin e Kurrikulave dhe rolin që luan ai.*

Lidhur me kriterin e Standardit VI.4.5: Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre ...
Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij:

Komenti i GVJ: GVJ (bazuar në dokumentat e paraqitura nga IAL KUW para dhe pas vizitës në IAL, i qëndron mendimit të tij për këtë kriter dhe sugjerimit përkatës, pra bazuar dhe në dokumentacionin përkatës, është gjë e mirë që është krijuar ky bord që në vitin 2019, por GVJ mendon që kontributi i tyre duhet të jetë më i madh ose të pasqyrohej më saktë veprimtaria e tyre dhe e dokumentuar tek RVB, si dhe të shihet mundësia e përfshirjes së ekspertëve të jashtëm dhe ish të diplomuar/alumni që janë të suksesshëm në punën e tyre dhe që e njohin mirë këtë fushë.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Akreditimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim biznesi”, të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Wisdom”, është bërë për herë të parë me Vendim të Këshillit të Akreditimit APAAL nr. 158, datë 16/05/2016. Institucionit nuk iu është lënë asnjë rekomandim nga Këshilli i Akreditimit për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim biznesi”.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim biznesi”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “WISDOM” ofron programe studimi që përputhen me interesat kombëtare. Kjo gjë është e shprehur qartësisht në Planin Strategjik të Zhvillimit të Kolegjit Universitar “WISDOM”, miratuar me Vendim Senati Nr. 7, datë 18/12/2017, sipas të cilit ky institucion synon të bëhet qendra e arsimit universitar, pasuniversitar, e kërkimit dhe e trajnimit për përgatitjen profesionale dhe shkencore të specialistëve të fushës së ekonomisë, drejtësisë dhe psikologjisë, me synimin e përgatitjes së specialistëve të kualifikuar, por edhe qytetarëve të përgjegjshëm dhe të kulturuar, në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit cilësor dhe të qëndrueshëm të vendit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 1.03 Planit Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom</p> Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.



Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.

Sipas Statutit të Kolegji Universitar "WISDOM", Neni 4, qëllimi dhe misioni i Kolegji Universitar "WISDOM" janë:

1. Garantimi i lirisë akademike si dhe respektimi i detyrimeve ligjore.
2. Zhvillimi i arsimit dhe shkencës në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari ligjore dhe transparente.
3. Ofrimi i studimeve të plota cilësore universitare të ciklit të parë, të dytë, studime të integruara në drejtësi dhe veprimtari mësimore e trajnuese profesionale, në përputhje me Kartën e Bolonjës, legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe me kërkesat dhe nevojat e institucionit, duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
4. Kryerja e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë, por jo vetëm.
5. Kryerja e kualifikimeve shkencore pasuniversitare, kurseve të specializimit dhe kurseve të kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë.
6. Sigurimi i cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke zbatuar metoda të avancuara moderne të mësimdhënies, ndër të tjera nëpërmjet nxitjes së të mësuarit aktiv, duke përdorur teknika, materiale dhe përvoja të universiteteve të zhvilluara perëndimore dhe nëpërmjet zbatimit të kriterëve të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies për stafin akademik dhe për studentët.
7. Vendosja e objektivave të qarta për çdo program, se çfarë duhet të dijë dhe çfarë do të jetë në gjëndje të bëjë pas përfundimit të programit.
8. Vendosja e një lidhje të fortë dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe veçanërisht me administratën shtetërore dhe komunitetin e biznesit nëpërmjet arritjes së një partneriteti të përhershëm shumëfunksional.

Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Menaxhim biznesi është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke ofruar kurrikula dhe mësimdhënie cilësore dhe bashkekohore.


Evidenca:

Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom

Aneksi 3 Nën Dosja (C)

<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Sipas dokumentave të vëna në dispozicion GVJ konstaton se nëpërmjet këtij programi Kolegji Universitar “WISDOM” ka synuar të ofrojë studime në përputhje me nevojat aktuale të tregut lokal dhe kombëtar. Studimet që ka bërë Kolegji Universitar “WISDOM” mbi kërkesat e tregut në këtë drejtim, kanë ndihmuar në përputhshmërinë e këtij programi me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Ofrimi i këtij programi studimi ka ardhur si kërkesë e tregut të punës për specialistë të Menaxhimit të biznesit. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuri në fushën e Menaxhimit të biznesit, pasi përmbajtja e programit i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur në këto fusha.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimi fitojnë njohuri teorike dhe aftësi praktike në menaxhim, ekonomiks, financë, kontabilitet, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e menaxhim biznesit, si në sektorin publik edhe atë privat.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom</p> <p>Aneksi 2.09 Studimi Periodik i Tregut i programit të studimeve Bachelor në “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p> <p>Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p> <p>Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është hartuar në përshatje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit e mbështetur kjo tek dokumentat strategjike të tij. Sipas Planit Strategjik Nr. 7, datë 18/12/2017, institucioni synon të jetë një qendër ekspertize e specializuar në fushën e menaxhimit, në vend dhe me ndikim në rajon e më gjerë.</p> <p>Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu</p>




	mundësinë e karrierës së tyre profesionale.			
	Evidenca: Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konstatoi se Kolegji Universitar "WISDOM" ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike të tilla si Plani Strategjik Nr. 7, datë 18/12/2017, sipas të cilave institucioni synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me kërkesat e "Kartës së Bolonjës", dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përbushjes së Misionit të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar "WISDOM" Neni 4. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të tjera të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete.			
	Evidenca: Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom" Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Sipas Planit Strategjik Nr. 7, datë 18/12/2017, Kolegji Universitar "WISDOM" i ka dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulave, strukturës së programeve dhe diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës. Këtë gjë Kolegji Universitar "WISDOM" e ka bërë edhe nëpërmjet ofrimit të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e të cilit është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Kolegjit Universitar "Wisdom".			
	Evidenca: Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom" Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022			
Shkalla e përbushjes së standardit	Në përbushje	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.

Mbështetur tek dokumentat strategjike të Kolegji Universitar "WISDOM", Plani Strategjik Nr. 7, datë 18/12/2017, GVJ konstaton se Kolegji Universitar "WISDOM" ka si mision profilizimin e Kolegjit Universitar "WISDOM" në fushat e shkencave ekonomike, juridike dhe të psikologjisë, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës.

Sipas Planit Strategjik të Zhvillimit, objektivat kryesore të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi në tërësinë e tyre synojnë të përgatisin specialistë kompetentë "liderë të mendimit dhe të veprimit" të profilit të Menaxhim Biznesi, që synon:

1. Krijimin e kushteve, mundësive dhe mjeteve që gjatë ofrimit të programit, studentët të realizojnë studime të thelluara dhe praktikë mësimore në profilin e Menaxhimit, të përvetësojnë njohuri, metoda e teknika të analizës së performancës drejtuese, ekonomike, financiare, menaxheriale, marketing, burimeve njerëzore, etj., të subjekteve publike dhe private, në mënyrë etike dhe shkencore dhe përgatitja për praktikën profesionale të pavarur si drejtues të subjekteve publike dhe private, duke punuar në institucione ku nevojitet drejtimi i avancuar në nivele të larta dhe cilësore, si dhe për të ofruar shërbimin e tyre si profesionistë të lirë në fushën e konsulencës së drejtimit të subjekteve publike dhe private.
2. Krijimin e kushteve, mundësive dhe mjeteve që pas përfundimit të programit, studentët të jenë në gjëndje të ndërtojnë njohuritë, kompetencat profesionale, vlerat dhe besimet e nevojshme për trajtimin bashkëkohor të çështjeve në fushën e menaxheriale si dhe për praktikën profesionale të pavarur në institucione publike dhe private.

Gjithashtu programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi ju jep studentëve njohuritë bazë formuese në fushat e ekonomiksit, matematikës, menaxhimit, komunikimit në biznes, kontabilitetit, menaxhimit të burimeve njerëzore, etj., me objektiv kryesor formimin e specialistëve të menaxhimit të biznesit dhe mundësisë për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.

GVJ konstaton se dijet që marrin studentët në përfundim të këtij programi studimi në fusha të tilla si menaxhimi, financa, kontabiliteti, etj., të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi e karakterizojnë profilin e tij.

Evidenca:

Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"

Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom

Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi"

Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022

	<p>Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p> <p>Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara si dhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “WISDOM” ka zhvilluar një studim të tregut të punës periodik së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna të marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët bazikë të programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.09 Studimi Periodik i Tregut i programit të studimeve Bachelor në “Menaxhim Biznesi”</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënërit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Sipas Rregullores të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi, struktura e këtij programi studimi është e organizuar në 5 kategori të lëndëve formuese. Ky program studimi përgatit studentë me njohuri bazë në drejtimin ekonomik dhe menaxherial, duke ju siguruar atyre mundësi punësimi si menaxherë specialistë me njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit.</p> <p>Objektiv i këtij programi është përgatitja e specialistëve të menaxhim biznesit të aftë në implementimin e njohurive menaxheriale për zgjidhjen e problemeve ekonomike apo të drejtimit. Për realizimin e këtij objektivit në program janë përfshirë lëndë të tilla si: Menaxhim Biznesi, Kontabilitet Kosto dhe Drejtimi, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Sjellje Organizative, Menaxhim Operacionesh, etj., të kombinuara me lëndët nga fusha e përgjithshme e ekonomisë.</p> <p>Nga ana tjetër për të garantuar që dijet e përfituara i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, institucioni ka kryer takime frekvente ku ka ndarë me ish studentë mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe ka kërkuar sugjerime e përshtypje për ndryshime, reformime e përmirësime të mundshme.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.09 Studimi Periodik i Tregut i programit të studimeve Bachelor në “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 4.04.1 Dosja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është ofruar që nga viti 2011 nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore i Kolegji Universitar “WISDOM”.</p> <p>GVJ u informua gjatë bisedave me drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë përgjegjëse për këtë program studimi se institucioni ofron kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e departamenteve. Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi janë angazhuar 13 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">- 1 pedagog me titullin akademik Profesor;- 2 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar;- 4 pedagogë me gradën Doktor;- 1 pedagog në proces doktorature;- 6 pedagogë me kualifikimin MSc. <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.21 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësine Kryesore dhe Njësine Përgjegjëse</p> <p>Aneksi 2.21.1 Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 2.21.2 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë si njësi bazë përgjegjëse nën drejtimin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, si njësi kryesore, por duke vijuar bashkëpunimin me Departamente të tjera të fakultetit.</p> <p>Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni për strategjinë e kërkimit shkencor GVJ konstatoi se direktivat dhe udhëzimet kombëtare evropiane plotësohen.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga</p>	<p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.05 Raporti vjetor i Kolegjit Universitar “Wisdom” viti akademik 2021-2022</p> <p>Aneksi 3 Nën Dosja (C)</p>



njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, është përgjegjës Departamenti i Ekonomisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni (Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”) GVJ është i mendimit se Kolegji Universitar “WISDOM” ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Evidenca: Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM” Aneksi 2.06 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar “WISDOM”
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	GVJ ka konstatuar se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendas (p.sh. Centery 21, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, La Sapienza, Albeton 5, EdilAL, Universiteti Aldo Moro Itali, etj.) bazuar kjo tek dokumentat e vëna në dispozicion të tilla si: Raporti Vjetor i NJKSHMJ, Viti Akademik 2020 – 2021; Lista e Marrveshjeve, etj. Evidenca: Aneksi 4.01 Raporti Vjetor i Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Aneksi 4.01.1 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” 2018-2021 Aneksi 4.01.2 Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” 2017-2019 Aneksi 4.03 Tabela përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 4.04.1 Dosja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e	Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Raporti vjetor, Viti Akademik 2020 – 2021, Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit, etj.), GVJ mendon se njësia përgjegjëse për këtë program ka hartuar në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 4.01 Raporti Vjetor i Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënies me Jashtë Aneksi 4.01.1 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” 2018-2021 Aneksi 4.01.2 Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” 2017-2019 Aneksi 4.03 Tabela përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 4.05 Relacion për trajnimet Ndërkombëtare të Studentëve</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi” praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyrret nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Kolegji Universitar “Eiendom” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me disa institucione për kryerjen e praktikave profesionale. Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje me institucione të tipologjive të ndryshme, të sektorit publik por edhe privat, brenda dhe jashtë vendit, si p.sh. Universiteti i Tiranës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Universitë degli studi di Padova, Itali, Coca-Cola bottling Shqipëri, Century 21, Qendra TED, Happy Group, etj.</p> <p>Evidenca: Aneksi 4.03 Tabela përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” Aneksi 3.02 Rregullore e praktikës mësimore profesionale për Programin e Studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi”</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ofron trajnime profesionale për studentët. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, evidentojmë që ofrohen prej tyre trajnime ose internship-e. Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit, si dhe në takimin me studentët, GVJ konstatoi se institucioni ofron trajnime për studentët me tematika të ndryshme duke rritur dhe zgjeruar cilësinë e formimit të tyre profesional. Studenti i cili ishte pjesë edhe e GVB, në vitin 2020 ka marrë pjesë në një trajnimin me temë “Empoëring Youth Entrepreneurship”, i mbajtur në Mostar, Bosnjë Hercegovinë. Një grup tjetër studentësh kanë qenë pjesë e një tjetër trajnimi të zhvilluar në Rumani, me tematikë “Communication for Social Inclusion”.</p> <p>Evidenca: Aneksi 4.03 Tabela përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 4.05 Relacion për trajnimet Ndërkombëtare të Studentëve</p>




	Aneksi 4.05.1 Relacion Trajnimi "Përse kryejmë kërkim Shkencor?"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (RVB; Rregullore e Kolegji Universitar "WISDOM", Baza Ligjore, Forma e studimit; Kurrikula e Programit; Plani Mësimor, etj) se studimet në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi", janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite përkatësisht 60 kredite në vit (në total 180 kredite), sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës. Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "WISDOM"
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Sipas dokumentave, Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim Biznesi" i ofron studentëve mundësinë e përfitimit të njohurive teorike dhe aftësi praktike në menaxhim, ekonomiks, financë, kontabilitet, dhe në modelimin e proceseve të biznesit dhe të të dhënave të ndryshme. Me anë të këtij formimi ata do të kenë mundësi të punojnë si menaxherë të niveleve të ndryshme, dhe mund të implementojnë njohuritë e marra gjatë studimeve. GVJ konstaton se kjo gjë mbështetet tek kurrikula e programit.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Në bazë të dokumentave parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës për këtë program studimi është: 17% të programit e zënë njohuritë bazë dhe formimi i përgjithshëm; 51.7% të programit e zënë lëndët e formimit karakterizues; 13.9% e zënë lëndët interdisiplinore, integruese dhe kurset e lira, pothuajse 13.3% lëndët plotësuese dhe 3.3% punimi i diplomës. Literatura e lëndëve ka kryesisht karakter gjithëpërfshirës. Evidenca:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p> <p>Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion konstaton se objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën menaxheriale të biznesit dhe ekonomisë me objektivi kryesor formimin e Menaxherëve specialistë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon studime me lëndë në fusha të tilla bazë si Menaxhim Biznesi, Drejtim Marketingu, Kontabilitet Financiar, Analizë Financiare, Menaxhim i Sistemeve të Informacionit, etj. të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi, etj. Gjithashu parimi themelor i ndërtimit të programeve të lëndëve është që pjesën më të madhe ta zenë njohuritë bazë dhe ato të thelluara. Në këtë aspekt GVJ është i mendimit se kryesisht ky program studimi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë në fushën e tij të studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me to, Kolegji Universitar “WISDOM” ka hartuar dokumentat e tij, të tillë si “Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, të cilat përcaktojnë strukturën e programit të studimit me të gjithë elementët e tij.</p> <p>Evidenca: Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM” Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstatoi se ky program studimi i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese të grupuara sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite përkatësisht:</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (32 ECTS). • Kategoria B: Lëndë të formimit karakterizues – përgatitje për disiplinën shkencore, 13 lëndë (93 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe

	<p>disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (25 ECTS).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 4 lëndë (24 ECTS). • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS). <p>Evidenca: Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Administrim biznesi ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, si njësi kryesore, në Kolegji Universitar “WISDOM”. Duke u mbështetur tek dokumentat: Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”; Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Menaxhim Biznesi”, GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Për këtë program studimi koordinatori është caktuar me anë të Vendim Nr. 435, datë 04/10/2021, të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Koordinatori është pedagog që mban titullin akademik MSc. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Detyrat kryesore të Koordinatorit përcaktohen në aktet rregullatore të Kolegjit Universitar “WISDOM”.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur GVJ konstatoi se detyrat e koordinatorit të programit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Wisdom” ku evidentohet që ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”</p>

	<p>Aneksi 2.13 Vendimi për përcaktimin e Koordinatorit të Programit të Studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 2.13.Relacion i Koordinatorit për Programin e Studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi”</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Kolegjit Universitar “WISDOM” dhe Statuti i Kolegjit Universitar “WISDOM” janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion (Rregullore e Kolegji Universitar “WISDOM”, Statuti i Kolegjit Universitar “WISDOM”).</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”</p> <p>Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar “Wisdom”</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në bazë të Urdhërit MASR nr. 241 datë 31/05/2011, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, përgjegjës për këtë program studimi, përbëhet nga 3 njësi bazë, në përputhje me kërkesat ligjore. Këto njësi bazë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Departamenti i Ekonomisë ● Departamenti i Psikologjisë ● Departamenti i Njësive të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë <p>Departamenti i Ekonomisë si njësia përgjegjëse për këtë program studimi dhe si e tillë përmbush kërkesën e ligjit për numrin e PAE (të paktën shtatë anëtarë) dhe raportin me PAK. Departamenti i Ekonomisë përbëhet nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm dhe raporti i mësimdhënies është 88.9% PAE dhe 11.1% PAK, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr. - 1 Prof. Asoc. Dr. - 4 Dr. - 1 proces Dr - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 1 pedagog, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Asoc. Dr. <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.21 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Përgjegjëse</p> <p>Aneksi 2.21.1 Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 2.21.2 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Kolegjit Universitar “WISDOM” dhe Statuti i Kolegjit Universitar “WISDOM” janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në</p>




ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion (Rregullore e Kolegji Universitar “WISDOM”, Statuti i Kolegji Universitar “WISDOM”).</p> <p>Evidenca: Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM” Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar “Wisdom”</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacione gjenden në dokumentat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Kolegji Universitar “WISDOM”; • Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”; • Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi; • Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi. <p>Gjatë vizitës në institucion studentët na informuan që të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve dhe materialeve që hidhen në Portalin e Studentit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3 Nën Dosja (C) Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM” Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar në dokumentin “Rregullore e Kolegji Universitar “WISDOM”, Kreu II, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi rregullat e organizimit të Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe</p>

<p>fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>organet drejtuese.</p> <p>Në përputhje me këtë rregullore, dokumenti “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Kreu II, Kurrikula e Programit të studimit, përcakton qartë lëndët, modulet, praktika dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Ndarja specifike është e pasqyruar tek Plani Mësimor të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Menaxhim Biznesi” nga të cilat kemi:</p> <p>Veprimtaritë formuese në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (32 ECTS). • Kategoria B: Lëndë të formimit karakterizues – përgatitje për disiplinën shkencore, 13 lëndë (93 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (25 ECTS). • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 4 lëndë (24 ECTS). • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS). <p>GVJ konstatoi se Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në vite e semestra. Kreditet e një discipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi: Neni 19, Metodatat, procedurat dhe kriteret e vlerësimit të studentëve.</p> <p>Në bazë të dokumentit Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi GVJ konstatoi se në të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këtë program studimi, të tilla si, frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, etj., janë të paraqitura në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi Neni 19, Metodatat, procedurat dhe kriteret e vlerësimit të studentëve, si dhe në Rregulloren e Kolegji Universitar “WISDOM”, Kreu VI.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 3 Nën Dosja (C)</p> <p>Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”</p> <p>Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”</p> <p>Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p> <p>Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit</p>	<p>GVJ bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>evidentoi se nëpërmjet Rregullore së Kolegjit Universitar “WISDOM” Kreu VI, VII dhe Statutit të Kolegji Universitar “WISDOM” , Kreu V, Neni 63 – Neni 69 përcaktohen kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve sipas legjislacionit në fuqi duke i orjentuar studentët specifikiisht sipas rregullore së programit të studimit përkatës.</p> <p>Kriteret e pranimit dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studentëve për këtë program studimi përcaktohen në dokumentin Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Kreu IV dhe Kreu V; Pranimi i Studentëve dhe statusi i studentëve.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Aneksi 2.37 Rregullore e Transferimeve Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM”</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ evidentoi që të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”. Gjithashtu ky program studimi përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë ku gjenden informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, etj, në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3 Nën Dosja (C)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Rregullorja e Kolegji Universitar “WISDOM” Kreu VI përcaktojnë që lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ai shqyrtohet në Departament dhe dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “WISDOM” Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ evidentoi se ngarkesa dhe struktura e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Kreu VI, Organizimi i studimeve në Kolegjin Universitar Ësdom.</p> <p>Përcaktimet specifike për strukturën dhe kreditet e këtij programi studimi jepen në Planin Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Menaxhim biznesi përkatësisht ngarkesa në orë mësimore në auditor, si dhe puna individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 180 ECTS. Për shembull lënda e Menaxhim Biznesi e formimit karakterizues të programit të studimit, ka 7 kredite dhe zhvillohet me 5 orë në javë, duke e ndarë në 3 orë leksioni në auditor dhe 2 orë seminari, ku në varësi të temës për trajtim, pedagogu bën dhe ndarjen me praktikë, ushtrime etj. Pra, në total studenti për këtë lëndë impenjohet me 75 orë në auditor dhe 100 orë studim individual.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” Aneksi 2.17 Të dhëna tabelore, ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies dhe kontrollit të njohurive për programin Bachelor “Menaxhim Biznesi” Aneksi 3.07 Orari Mësimor 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave i mundësojnë studentëve të këtij programi studimi rritjen e aftësive profesionale dhe punësimin e tyre. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese. Kjo gjë mbështetet edhe në dokumentat e shqyrtuara.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3 Nën Dosja (C)</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi ofrohet në 3 vite mësimore, gjithsej 6 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë/në një semestër, dhe në përfundim të tij studentët marrin 180 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve bën të</p>




objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe arsimit profesional (Rregullore e Programit të studimit, Neni 8 dhe Neni 9; Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”). Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstatoi në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion por edhe gjatë bisedave me drejtuesit, pedagogët dhe studentët që struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. Në këtë program studimi parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës është parimi i rrathëve ku 17% të programit e zënë njohuritë bazë dhe formimi i përgjithshëm, 51.7% të programit e zënë lëndët e formimit karakterizues, 13.9% e zënë lëndët interdisiplinore, integruese dhe kurset e lira, pothuajse 13.3% lëndët plotësuese dhe 3.3% punimi i diplomës. Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore. Institucioni synon që zhvillimi i kurrikulave të programit t'i referohet praktikave më të suksesshme ndërkombëtare, me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me kurrikulat në universitetet perëndimore, për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, dhe për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet partnere për programe të përbashkëta studimi, ose dhënie të diplomave të dyfishta. Bazuar tek sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale. Evidenca: Aneksi 3.02 Rregullore e praktikës mësimore profesionale për Programin e Studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi”
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Rregullorja e Departamentit të Ekonomisë, Kreu IV përcakton që syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Propozimi për ndryshime bëhet nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, dhe diskutimeve në mbledhjet e departamentit,




	<p>etj.</p> <p>Gjithashtu sipas Rregullores së Kolegjit Universitar "WISDOM" dhe bisedave me NJBSC, GVJ konstatoi se literatura e detyruar dhe ndihmëse i përket viteve të fundit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 2.08 Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin lidhur me programin e studimit, konstaton se përmbajtja e programit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim Biznesi është brenda kuadrit të përfitimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave specifike për këtë program, e pasqyruar kjo edhe në rregulloren bazë të insitucionit. Ky program studimi synon të formojë profesionistë të fushës menaxheriale / administrative, të aftë për të punuar si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Evidenca: Aneksi 3.04 Planet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.05 Veprimtaria formuese e programit 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022 Aneksi 3.10 Programet Mësimore viti akademik 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në institucion dhe dhe Rregullores së Departamentit të Ekonomisë, Kreu II se programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti dhe nga anëtarë të personelit akademik në bashkëpunim me ekspertë të fushës me të cilët Kolegji Universitar "Eisdom" bashkëpunon. Institucioni në mbështetje të programit të studimit, ka ngritur strukturën e Bordit Këshillimor të Biznesit të përbërë nga kompani dhe biznese të ndryshme që nëpërmjet praktikës dhe eksperiencës së tyre, bëjnë propozime në departament.</p> <p>Evidenca: Aneksi 2.08 Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 4.03 Tabela përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 2.25 Vendim Bordi Këshillimor i Biznesit Aneksi 2.25.1 Bordi Këshillimor i Biznesit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar “Ëisdom”, Kreu IV, Neni 45 si dhe në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Ëisdom”, Kreu V dhe janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin akademik 2021 – 2022, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera.</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi janë angazhuar 12 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) (pedagogë jo vetëm nga Departamenti i Ekonomisë për realizimin e programit të studimit). Kurse, Departamenti i Ekonomisë përbëhet nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm dhe raporti i mësimdhënies është 88.9% PAE dhe 11.1% PAK, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr. - 1 Prof. Asoc. Dr. - 4 Dr. - 1 proces Dr - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 1 pedagog me titull shkencor Prof. Asoc. Dr.</p> <p>PAK që japin mësim në këtë program studimi, bazuar tek dokumenti “Tabela përmbledhëse: Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, 2021 – 2022. Të gjithë kanë kualifikimin e nevojshëm dhe gradat shkencore sipas kërkesave të ligjit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe atyre me kontratë.</p> <p>Në pjesën më të madhe të tij personeli akademik efektiv dhe me kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 2.24 Politikat e rekrutimit të personelit akademi në Ku Ëisdom. Modeli i skedës vlerësuese të kandidatëve.</p> <p>Aneksi 2.22.1 CV të stafit akademik dhe ndihmës akademik</p> <p>Aneksi 2.21.1 Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit “Menaxhim Biznesi”</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Ekonomisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi ka</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>një nivel kualifikimi dhe fushën akademike-kërkimore që është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi. Është evidentuar rritja e nivelit të kualifikimeve të stafit që është i angazhuar në mësimdhënie në Programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, ku vërehet se përgjatë këtij gjashtë vjeçari kanë marrë gradën Doktor 3 pedagogë (PAE).</p> <p>Evidenca: Aneksi 2.22.1 CV të stafit akademik dhe ndihmës akademik Aneksi 4.09 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe institucione të njohura në vend, si Kuvendi i Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Irisoft Education, EdilAL shpk, NOA sha, Fondacioni Arsimor Shqiptar, etj., institucioni ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm dhe të kualifikuar për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Përsa i përket udhëheqjes së punimit të diplomës kjo bëhet kryesisht nga pedagogët efektivë, të cilët gjithashtu kanë kualifikimin e duhur në përshtatje me programin e studimit.</p> <p>Evidenca: Aneksi 4.04.1 Dosja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit Aneksi 4.03 Tabelat përmbledhëse dhe Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione Aneksi 3.10 Programi i Lëndës “Praktikë Mësimore”</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në bisedat me drejtuesit dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua që në ndihmë të këtij programi studimi është edhe zyra e IT e cila ka një punonjës, i cili është në mbështetje edhe të procesit mësimor edhe të çështjeve teknike që lidhen me laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL Kolegji Universitar Wisdom (KUW) i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. Departamenti i Ekonomisë në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore në KUW e ka formalizuar me vendim përdorimin e mjeteve didaktike dhe metodave & teknikave bashkëkohore, si dhe të veprimtarive & workshopeve në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies interaktive. Gjithashtu, është krijuar dhe NJSBC (të formalizuara tek Statuti, Rregullorja e KUW & Rregullorja e NJSBC) e cila vlerëson periodikisht veprimtaritë mësimore & kërkimore-shkencore, dhe mbi bazën anketimeve jepen sugjerime lidhur me përmirësime potenciale lidhur me metodat e mësimdhënies, literaturën e përdorur, etj. Specifikisht lidhur me programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi metodat e mësimdhënies janë në ndryshim të vazhdueshëm. KUW ka organizuar dy workshope me pedagogët për trajnimin e tyre në varësi të fushës së studimit, lidhur me mësimdhënien dhe zhvillimin e kompetencave pedagogjike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i departamentit për materialet didaktike</p> <p>Aneksi 4.07.1. Dosja e plotë e workshopit të zhvilluar nga pedagogu amerikan Ronald M Nate</p> <p>Aneksi 4.12. Axhenda e trajnimit 4 ditor të Prof.As.Dr. Leticja Gusho me temë: Zhvillimi i kompetencave pedagogjike</p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW, neni 27</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW, neni 20</p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC, neni 15</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i KUW, Rregullore e KUW, Rregullore e NJSBC, etj), GVJ konstaton se IAL ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Konkretisht, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, e cila në bashkëpunim me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë e realizojnë këtë detyrë duke vlerësuar periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet kontrolleve, relacioneve të lëndëve, pyetësorëve të studentëve, dhe duke hartuar relacione që propozojnë ndryshime për përmirësime potenciale. NJSBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të KUW për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në KUW. Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative janë të formalizuara gjithashtu dhe tek Plani strategjik i KUW 2018-2023.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>

	<p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW, neni 27</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW, neni 20</p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC, neni 15</p> <p>Aneksi 1.03. Plani strategjik i zhvillimit KUW, pika 6</p> <p>Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë</p> <p>Aneksi 2.19.6. Relacion i kalendarëve të kontrollit të NJSBC</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Është pikërisht NJSBC e cila organizon plotësimin e pyetësorëve nga studentët (organizohet 2 herë në vit) për vlerësimin periodik të formave të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve. NJSBC miraton për çdo vit formatin template të pyetësorit që do të organizohet për studentët e çdo cikli studimi. Studentëve iu mundësohen nga IAL dhe takime me stafin akademik dhe administrativ në prani të NJSBC, ku mund të shprehin opinionet e tyre lidhur me procesin mësimor, si dhe ankesa potenciale që mund të kenë. Psh. procedura për ankesat lidhur me rezultatet e provimit është e tillë që kjo ankesë i drejtohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit ... ku nëse konstatohet gabim potencial i korrigjueshëm, bëhet ndreqja nga komisioni ... nëse është e pamundur të zgjidhet ankesa, procedura është e tillë që Përgjegjësi i Departamentit njofton Dekanin, i cili nga ana e tij brenda 48 orëve nga marrja dijoni, ngre një komision ad-hoc që verifikon pretendimet e studentit, komision i cili përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose në raste të caktuara mund të vendosë për ripërsëritje të provimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW, neni 20 & 89</p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC, neni 15</p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW, neni 27</p> <p>Aneksi 2.19.3. Model template: Pyetësori i studentëve</p> <p>Aneksi 3.08. Shembull ankimimi në Departamentin e Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe duke i bërë publike rezultatet e vlerësimit. NJSBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të KUW për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në KUW, raport i cili i vihet në dispozicion Rektorit dhe çdo pale të përfshirë në procesin e vlerësimit, si dhe publikohen dhe në faqen web të KUW. Duhet specifikuar, që tek NJSBC përfshihen dhe studentët, si palë kryesore e gjithë procesit për cilësi më të mirë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW, neni 27</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW, neni 20</p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC, neni 15</p> <p>Aneksi 2.19.1. Të dhëna tabelore për njësitë, individët, studentët dhe pale</p>





	të tjera të angazhuara në NJSBC			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>NJSBC harton çdo vit planin e veprimtarive kryesore. IAL KUW në bashkëpunim me NJSBC, bazuar në raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në KUW & në rezultatet dhe statistikat e tij, nxjerr konkluzione dhe rekomandime, si dhe planin e masave lidhur me përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies, për inkurajimin e personelit akademik për performancë më të mirë, etj. Në takimin me drejtuesit e KUW, GVJ u informua që në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimeve, diskutohen problematikat, por edhe praktikat më të mira të evidentuara, duke i promovuar ato me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Përveç NJSBC, një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe Departamenti i Ekonomisë, ku Përgjegjësja e këtij departamenti na informoi se në fillim të vitit akademik hartohet plani i punës për personelin akademik për vlerësimin e performancës së pedagogëve, në të cilin përfshihet përveç të tjerave edhe vlerësimi për mësimdhënien. Gjithashtu, Përgjegjësja e Departamentit në bashkëpunim me NJSBC organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në auditor për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë</p> <p>Aneksi 2.19.2. Plani i veprimtarisë kryesore të NJSBC për vitin 2021-2022</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Lidhur me programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të miratuara dhe të përdorura janë: leksionet/ seminarët/detyrat e kursit/ rastet studimore, përdorimi i ushtrimeve, projekteve të kërkimit në grup, etj, të miratuara/formalizuara nga IAL KUW edhe nëpërmjet Rregullores së programit të studimit BSc në Menaxhim Biznesi.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse të lëndëve. Personeli akademik gjatë zhvillimit të leksioneve apo seminareve përdor mjetet audivizive, powerpoint, diskutime etj.</p> <p>Për shkak të pandemisë Covid, nga ana e KUW u zhvillua procesi mësimor nëpërmjet platformës Microsoft Teams, kurse aktualisht po e zhvillojnë në auditor mësimin në bazë të urdhrit të MASR. Gjithashtu, KUW ka vendosur në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve Portalin e Studentit (i cili aksesohet në faqen web të IAL KUW), ku çdo pedagog</p>

	<p>ngarkon leksionet, syllabuset, detyrat, si dhe mundësohet dhe zhvillimi i provimeve online (nëse është e nevojshme). Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione/kompani publike dhe private sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar KUW me ta, të cilat i ndihmojnë studentët e programit BSc në Menaxhim biznesi që të fitojnë aftësi praktike dhe eksperiencë për të lidhur teorinë më praktikën, dhe përputhjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Konstatim i GVJ:</p> <p><i>Te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), syllabuset përmbajnë informacion vetëm për pjesën/modulin e Menaxhimit strategjik & Biznesit ndërkombëtar & Informatikës (dhe nuk përmbajnë informacion për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit</p> <p>Aneksi 2.18. Printscreen: Portali i studentit</p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik i KUW u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies (siç u specifikuan te kriteri më lart). Programi i studimit Bachelor në Menaxhim biznesi përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies, ku nga ana e personelit akademik nxitet pjesëmarrja aktive e studentëve në procesin mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive dhe përdorimit të mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit (kompjuterat me programet e duhura, projektorë, etj), sidomos në bërjen e prezantimeve në grup të rasteve të studimit apo të projekteve të kursit të kompanive të ndryshme të biznesit ... ku pedagogët ftojnë studentët të demonstrojnë në vlerësimin e situatës së bizneseve, problematikave të hasura dhe zgjidhjen e situatës/problematikave duke e vënë veten në rolin e menaxherit të biznesit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW mbështet personelin e tij akademik në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike nëpërmjet seminareve, workshop-eve, trajnimeve të organizuara për këtë qëllim me specialistë të fushave përkatëse, psh. organizimi i trajnimit lidhur me zhvillimin e kompetencave pedagogjike apo lidhur me risitë kurrikulare, etj. IAL KUW bën monitorimin e vazhdueshëm lidhur me aspektet</p>




<p>të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>akademike dhe vë në funksion të personelit akademik logjistikën e nevojshme për realizimin sa më mirë të procesit mësimor. Në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e IAL, KUW mundëson pajisje didaktike për realizimin e orëve të leksioneve dhe të seminareve me mjete & metoda të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.12. Axhenda e trajnimit 4 ditor të Prof.As.Dr. Leticja Gusho me temë: Zhvillimi i kompetencave pedagogjike</p> <p>Aneksi 4.12.1. Relacion mbi trajnimin per modulën: Formimi i stafit akademik lidhur me risitë kurrikulare në bashkepunim me Qendrën e trajnimeve dhe kurseve Irisoft</p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i Departamentit për materiale didaktike</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga GVJ konstatohet se Përgjegjësjë e Departamentit në mbledhjet përkatëse të departamentit, në çdo fillim viti akademik diskuton dhe shqyrton me stafin akademik probleme lidhur me përditësimin e syllabuseve të lëndëve në elementë të caktuar të tyre, si dhe departamenti nxit rritjen e performancës akademike për përdorimin e metodave didaktike të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi janë angazhuar 12 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK). Kurse, Departamenti i Ekonomisë përbëhet nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm dhe raporti i mësimdhënies është 88.9% PAE dhe 11.1% PAK, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr. - 1 Prof. Asoc. Dr. - 4 Dr. - 1 proces Dr - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 1 pedagog me titull shkencor Prof. Asoc. Dr.</p> <p><i>Konstatohet që disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc ... sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr. Gjithashtu, në dokumentat e paraqitura CV e stafit akademik duheshin më të plota dhe më të unifikuara si format (psh., disa janë në gjuhën shqipe, disa në gjuhën angleze, etj). Si dhe, tek RVB, kjo pikë duhej (apo duhet) plotësuar më plotë nga ana e grupit të punës.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p> <p>Aneksi 1.01-1.014. CV e pedagogëve</p> <p>Aneksi 2.21.1. Personeli akademik BMB</p>




	<p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i Departamentit për materiale didaktike</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se personeli akademik është gjithmonë i fokusuar tek përmirësimi i metodave të mësimdhënies. Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, personeli përballet me kërkesat apo sugjerimet e studentëve për procesin mësimor nëpërmjet raporteve periodike që harton NJSBC (çdo vit) bazuar te përdorimi periodikisht i pyetësorëve (çdo vit miratohet pyetësori template) me studentët (duke ruajtur anonimin e tyre), por dhe në takime apo biseda të drejtuesve të IAL me studentët me qëllim për të marrë opinionin e studentëve lidhur me programet e studimit, të personelit akademik dhe çdo lëndë të këtij programi. Informacioni që merret nga këta pyetësorë lidhur me vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve, iu kalon pedagogëve përkatës, të cilët bazuar në mendimet dhe sugjerimet e studentëve, bëjnë vlerësimin përkatës dhe përmirësojnë format dhe metodat përkatëse të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.19.3. Model template: Pyetësori i studentëve</p> <p>Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit të Studentëve</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit, por edhe pedagogët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ u informua që synimi i IAL KUV është që të promovojë metodat e reja të mësimdhënies me në qendër studentin, duke përdorur metoda interaktive dhe diskutimi për kontrollin e dijeve të fituara nga studentit, apo edhe duke i dhënë rëndësi punës së pavarur/individuale të tyre, por dhe punës në grup nëpërmjet rasteve të studimit, detyrave të kursit, eseve, etj, apo duke simuluar situata/problematika të ndryshme në kompani të caktuara duke aplikuar metodën role-playing, dhe duke arsyetuar mbi zgjidhjet që do aplikonin studentët duke e vënë veten e tyre në pozicione të ndryshme në këto organizata dhe marrjen e vendimeve përkatëse për zgjidhjen e problematikave të hasura, etj, mënyra të cilat i bëjnë më tërheqëse orët e mësimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p> <p>Takimi me stafin akademik</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>IAL KUV në bashkëpunim me NJSBC synon të zbatojë politikën e duhur të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë & standardeve të programeve të saj të studimit. Duke pasur si synim studentin në qendër, përdorimi i formave të reja të mësimdhënies inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve duke i bërë ata më autonomë në të menduar e vepruar. GVJ u informua nga studentët se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët ishte nxitja e tyre që të merrnin pjesë aktive gjatë procesit mësimor dhe të zhvillonin detyra në grup dhe projekte kursi të pavaruara & ku kërkohej mendimi kritik i tyre, dhe se marrëdhëniet pedagogë-studentë karakterizoheshin nga një frymë bashkëpunimi e</p>




	mirëkuptimi për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimdhënës dhe mësimnxënës.			
	<i>Evidenca:</i> Aneksi 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe tek vizita e GVJ në mjediset e IAL K UW, GVJ konstaton se veprimtaria akademike e K UW realizohet në hapësira të bollshme dhe cilësore. Bazuar tek dokumentacioni mbështetës, institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në një ambient (i marrë me qera deri në mesin e vitit 2026) të pozicionuar përgjatë autostradës Tiranë-Durrës, që ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</p> <p>Ambientet janë komode dhe plotësojnë kushtet higjieno sanitare të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të studentëve, pedagogëve dhe stafit ndihmës akademik & administrativ. Pra, në tërësi, për studentët krijohet një mjedis i mirë për ndjekjen e leksioneve dhe seminareve.</p> <p><i>Sugjerohet nga GVJ që tek auditorët të mbyllet pjesa lart e mureve (janë të hapura) sepse krijon probleme/konfuzion/zhurma kur zhvillohet mësim në shumë salla njëkohësisht.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.28. Planimetria dhe infrastruktura Aneksi 2.29. Kontratë qeraje</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Ambientet e dedikuara për procesin mësimor në IAL K UW janë funksionale (të pastra, me ndriçim dhe ajrosje, me sistem ngrohje & ftohje) & të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor për të arritur objektivat e programit të studimit të ciklit të parë BSc në Menaxhim Biznesi. Në mbarëvajtje të procesit mësimor, gjendet dhe një sallë interneti dhe biblioteka të cilat janë me akses të lirë. K UW disponon sallë kompjuterash me 22 poste, si dhe auditorët janë të pajisura me bazën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>materiale të nevojshme për ecuri sa më të mirë të procesit mësimor. Aktualisht disponohen 22 kompjutera (por ka hapësirë për të shtuar dhe disa poste/vende të tjera), 8 printera, 3 fotokopje, 4 videoprojektorë, 1 njësi video konference, 1 sistem fonie. Normalisht, zyrat e personelit akademik janë të pajisura me kompjutera dhe gjithë bazën e nevojshme materiale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.28. Planimetria dhe Infrastruktura</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>IAL K UW ka një infrastrukturë të konsoliduar IT dhe një laborator të teknologjisë së informacionit i cili është i pajisur me software për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe për sistemin e komunikimit të brendshëm, sistem i cili për akses në dokumentacionin elektronik është i konsoliduar për personelin akademik dhe për studentët. Portali i Studentit (aksesohet në faqen web të IAL K UW me username dhe fjalëkalim) është porta hyrëse, ku çdo pedagog dhe çdo student ka akses në sistemin e komunikimit të brendshëm elektronik, ku secili ka akses nëpërmjet llogarisë së përdoruesit (username) dhe me fjalëkalimin përkatës. Rubrikat që gjenden tek ky portal janë paneli i kontrollit, mesazhet, pedagogët, lëndët, orari, libraria, njoftimet, etj. Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë dhe bibliotekën online nëpërmjet llogarisë personale dhe fjalëkalimit përkatës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.28. Planimetria & Infrastruktura</p> <p>Aneksi 1.17. Udhëzues për monitorimin e STI</p> <p>Aneksi 2.18. Print Screen: Portali i Studentit</p> <p>Aneksi 1.20. Të dhëna platforma online, struktura TIK, etj</p> <p>Aneksi 1.18. Politika institucionale e publikimit</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Vlen të theksohet që K UW në mënyrë të vazhdueshme pasuron literaturën në përputhje me kurrikulat mësimore për të garantuar marrjen e dijeve të duhura të parashikuara në programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi. Departamenti i Ekonomisë harton plane të detajuara për shtimin e librave në bibliotekë dhe i bën në mënyrë të vazhdueshme propozime Dekanit dhe Administratorit të K UW për blerjen e librave të rinj mësimorë. Në mënyrë të vazhdueshme bëhen blerje të librave, të artikujve shkencore, si dhe biblioteka pasurohet dhe me revista shkencore në fushën e ekonomisë. Disa nga këto literature aksesohen dhe në faqen Web të IAL K UW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e KU Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodikeve në Bibliotekë shtuar vitet e fundit</p> <p>Aneksi 2.20.1. Propozim nga Departamenti i Ekonomisë për blerjen e titujve të nevojshëm në Bibliotekë për v.ak. 2021-2022</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (Inventari i Bibliotekës së K UW) GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj një sasi të konsiderueshme librash fizikë, si dhe mjaft periodikë revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, këto të disponuara në versionin hardcopy dhe elektronikisht; kurse Departamenti i Ekonomisë zotëron rreth 270 tituj libra</p>

<p>komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>fizikë gjithsej, si dhe disponohen dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve.</p> <p>Biblioteka ka 45 poste/vende që janë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve, të cilët mund të marrin informacion, por dhe të përdorin librat në dispozicion. Këtu studentët mund të bëjnë dhe fotokopje të ndryshme të materialeve që gjenden në bibliotekë. Përdoruesit e bibliotekës mund të aksesojnë dhe internetin, i cili krijon kushte të mira për studime online, konsultimin me materiale të ndryshme shkencore, etj, si dhe nëpërmjet 12 laptopëve të vënë në dispozicion, studentët mund të përgatisin projektet e kursit apo temat e diplomës. Biblioteka e KUW është e abonuar në revistat shkencore si The economist, Monitor print, Business week, etj.</p> <p>Përgjegjësit e programeve hartojnë plane të detajuara për shtimin e zërave të bibliotekës dhe i bëjnë propozime Rektoratit dhe Administratorit të KUW për pasurimin me tituj të rinj të librave shkencorë.</p> <p><i>Përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka e IAL KUW, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave në të ardhmen për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë. Pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave fizikë për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Menaxhim biznesi. Si dhe numri i kompjuterave/laptopëve në bibliotekë është i vogël dhe sugjerohet shtimi i kompjuterave/laptopëve për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e KU Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodikeve në Bibliotekë shtuar vitet e fundit</p> <p>Aneksi 1.20. Të dhëna platforma online, struktura TIK, etj</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>KUW iu jep mundësinë studentëve dhe pedagogëve të tij që të kenë akses në librat fizikë apo të aksesojnë libraritë online, ku një ndër to është dhe aksesimi i website ProQuest. Biblioteka online ProQuest ofron një mori titujsh librash akademikë online në formatin pdf, veçanërisht ato në fushën ekonomike, të menaxhimit, të biznesit, dhe financë-bankë, të cilat mund të aksesohen nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Sipas drejtuesve të KUW, kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Premier Publishing S.R.O. si dhe po sipas tyre, biblioteka e KUW është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik Cobiss.al (Cobiss është aplikacion elektronik që u mundëson bibliotekave dhe përdoruesve akses në bazat e të dhënave të këtij sistemi ... biblioteka është e automatizuar ku librat regjistrohen në regjistrin elektronik). Çdo student dhe pedagog i KUW ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdormit të katalogut elektronik online të cobiss.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e KU Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodikeve në Bibliotekë shtuar vitet e fundit</p>




	<p>Aneksi 1.20. Të dhëna: plaforma online, struktura TIK, etj</p> <p>Aneksi 2.38. Pagesa ProQuest janar '22</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi funksionon laboratori i informatikës (me 22 poste ... ku kanë të instaluar programet SPSS, EvIEWS) i cili mund të shfrytëzohet nga studentët e këtij programi për të përgatitur detyrat në grup dhe projektet e kursit. Gjithashtu, studentët mund të përdorin dhe bibliotekën (45 poste në dispozicion), ku aty janë vendosur dhe 12 laptopë që mund të përdoren nga studentët për kryerjen e detyrave të ndryshme.</p> <p>IAL KUW ka lidhur marrëveshje me kompani të ndryshme si Concord shpk, Europa caffè, Edil al, Albeton 5, Egnatia TV, Albabeton, etj, ku studentët e këtij programi studimi mund të ndjekin praktikën mësimore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e KU Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodike në Bibliotekë shtuar vitet e fundit</p> <p>Aneksi 1.20. Të dhëna plaforma online, struktura TIK, etj</p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.01.2. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve Bachelor në Menaxhim Biznesi 2017-2019</p> <p>Aneksi 4.04.1. Marrëveshje bashkëpunimi</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i KUW është i angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, dhe mbështetin & nxit kolegët e tyre dhe studentët për përdorimin e këtyre teknologjive. Konkretisht, përdoret platforma online Portali i Studentit dhe platforma Teams, platforma në të cilat personeli akademik i KUW ngarkon materialet mësimore sipas lëndëve, leksionet, syllabuset dhe materialet e tjera të studimit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Përdorimi i këtyre platformave u nxit më shumë nga pandemia Covid '19, periudhë në të cilën mësimi zhvillohej online.</p> <p>Duhet thënë që pedagogët që japin mësim në programin BSc në Menaxhim biznesi i përdorin të gjitha burimet elektronike që ofron IAL të tilla si internetin, bibliotekën online Proquest, portalin e studentit, dhe mjetet audiovizive për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p><i>Në fakt mungon një platformë standarde e-learning (sipas RVB të KUW), por IAL ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Rosetta Stone për platformë online të studimit në gjuhën angleze.</i></p> <p><i>Konstatohet që mungon një platformë standarde e-learning (edhe sipas RVB të KUW).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.20. Të dhëna plaforma online, struktura TIK, etj</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë</p>	<p>IAL ka kompjutera me akses në internet dhe komunikimi ndërmjet personelit akademik dhe atij administrativ zhvillohet nëpërmjet domainit të kolegjit</p>





<p>sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>zyrtar. Gjithashtu, biblioteka online mund të aksesohet nga zyrat e personelit akademik, si dhe nga laptopët e vendosur në bibliotekë. Gjithashtu, pedagogët dhe studentët (nëpërmjet adresave zyrtare) përdorin Portalin e Studentit si platformë komunikimi më njëri-tjetrin, të cilin e aksesojnë në faqen ëeb të IAL KUË.</p> <p><i>Në fakt, sugjerohet nga GVJ që në të ardhmen GVB duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi informacionit që jep për plotësimin e kriterëve të standardeve (në rastin konkret për standardin III.3.9?!</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Lidhur me programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore ka miratuar rregulloren për diplomat, ku bazuar në këtë rregullore, sipas personelit akademik, ata bëjnë takime periodike me studentët dukë bërë orientimet e duhura për ta lidhur me temat e diplomës dhe zhvillimin e tyre. Temat e diplomës të shpallura nga Dekanati, bëhen publike dhe studentët me notë mesatare mbi 8.5 bëjnë zgjedhjet përkatëse (mbrojnë me temë diplomë studentët që deri në semestrin e pestë kanë mesatare 8.5 e më lart ... sipas RVB të IAL KUW). GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë. Nga takimi me drejtues te IAL, u konstatua nga GVJ që deri më tani studentët që përfundojnë studimet BSc në Menaxhim Biznesi, diplomën e mbrojnë me provim të përgjithshëm.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat, mbrojtjes së temave të diplomës</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i KUW, Komisionet e përhershme), GVJ konstaton se IAL ka ngritur struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe koordinojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, konkretisht ka ngritur Komisionet e përhershme të cilat janë Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë, Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulës, Komisioni për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe koordinimin, si dhe ka ngritur NJSBC si strukturë autonome e përhershme e cila vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke hartuar raporte vjetore dhe propozuar ndryshime që kanë të bëjnë me përmirësimet</p>

	<p>potenciale të proceseve të caktuara që shfaqin problematika.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW; nenet 13, 22, 27</p> <p>Aneksi 2.27. Komisionet e përhershme. Vendim emërimi</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë është njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, konkretisht duke synuar ofrimin e programeve bashkëkohore të studimit nëpërmjet angazhimit të stafëve të duhura dhe të përkushtuara akademike, duke ndërtuar dhe marrëdhënie të mira me kompani të ndryshme vendase dhe të huaja që i ndihmojnë studentët në kryerjen e praktikave, etj. Departamenti i Ekonomisë bashkëpunon me NJSBC për çështje të caktuara që kanë lidhje me programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, dhe marrjen e masave të duhura të përmirësimit.</p> <p>Në mënyrë periodike, Departamenti i Ekonomisë bën dhe analizën vjetore sipas fushave përkatëse. E njëjta gjë bëhet dhe nga Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me jashtë. Qëllimi është që të ketë përmirësime në ato fusha/sectorë që kanë nevojë për ndërhyrje.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.11. Programi i veprimtarisë kryesore të Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021</p> <p>Aneksi 4.01. Raport vjetor i Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë 2020-2021</p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.01.2. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve Bachelor në Menaxhim Biznesi 2017-2019</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton gjithashtu se njësitë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi i japin një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe mënyrave audiovizive në zhvillimin e lëndëve të ndryshme. Gjithashtu, IAL ka hartuar planin strategjik të zhvillimit 2018-2023 ku ka përcaktuar prioritetet dhe objektivat strategjike në përputhje me sfidat që hasen nga arsimit i lartë, si dhe objektiva konkrete që lidhen me zhvillimin e përmirësimit të programeve, etj. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse kanë organizuar aktivitete kërkimore shkencore apo trajnuese të tilla si leksione të hapura në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë si psh. me Universitetin Ndërkombëtar të Shkupit, apo konferenca studentore ndëruniversitare në bashkëpunim me universitete të ndryshme të vendit, si dhe mobilitete Erasmus+ të stafit akademik me të cilët kanë marrëveshje.</p> <p><i>GVJ mendon se duhet të kishte më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.</i></p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.03. Plani strategjik i zhvillimit të KUW</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ u informua se KUW ofron angazhimin e vet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e kërkimit shkencor. Kështu, gjatë 6 viteve të fundit në programin BSc në Menaxhim Biznesi kanë marrë gradën Dr. disa pedagogë. IAL KUW mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik dhe atij mbështetës në mobilitetet ERASMUS+ dhe projekte me partnerë të huaj (psh. disa pedagogë kanë ndjekur zbatimin e projektit në fazat Transnational dhe Learning mobility), si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe aftësive kërkimore, si dhe pedagogët e programit angazhohen në konferenca të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas drejtuesve të IAL KUW, në sajë të marrëveshjeve të përbashkëta me Universitetin Aldo Moro, Itali, Universitetin e Shkupit, Maqedoni e Veriut apo Qendra e Kërkimit dhe Studimeve, Turqi, ka patur angazhim të pedagogëve në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Në mënyrë periodike hartohen raporte/relacione për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p><i>GVJ mendon se duhet të kishte më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.09. Të dhënat e plota të kualifikimit dhe kërkimit shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit</p> <p>Aneksi 4.01.2. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve Bachelor në Menaxhim Biznesi 2017-2019</p> <p>Aneksi 2.22. Dosje personale stafi</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se IAL i mundëson stafit akademik trajnime në përputhje me programin vjetor të Departamentit të Ekonomisë dhe planit vjetor të Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë. Trajnimet konsistojnë kryesisht në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, GVJ konstaton se seminarët & trajnimet e stafit kanë konsistuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Seminarin: Për të mësuarit si detyrë e vështirë, seminar i kryer nga një profesor amerikan. - Trajnime për zhvillimin e kompetencave pedagogjike, trajnim mbi Shkrimin dhe menaxhimin e projekteve, trajnimi mbi Formimin e stafit akademik lidhur me risitë kurrikulare, trajnime të kryera nga profesorë shqiptarë. - Si dhe leksione të hapura nga lektorë të huaj; etj. <p><i>Evidenca:</i></p>




	<p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 2.11. Programi i veprimtarisë kryesore të Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 4.12. Axhenda e trajnimit 4 ditor të Prof.As.Dr. Leticja Gushe me temë: Zhvillimi i kompetencave Pedagogjike</p> <p>Aneksi 4.07. Relacion mbi pjesëmarrjen e stafit akademik në trajnimin Shkrim dhe Menaxhim Projektsh 2020</p> <p>Aneksi 4.07.1. Dosja e plotë e Workshopit të zhvilluar nga pedagogu amerikan Ronald M Nate</p> <p>Aneksi 4.02. Programi i veprimtarive kryesore të NJKSHMJ 2019-2020; 2020-21; 2021-22</p> <p>Aneksi 4.12.1. Relacion mbi Trajnimin për Modulën Formimi i stafit akademik lidhur me risitë kurrikulare në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimeve dhe kurseve Irisoft</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në bazë të informacioneve të marra në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë dhe pedagogët e këtij programi studimi, GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, madje Departamenti i Ekonomisë e sheh si prioritet zgjedhjen e nje stafi të kualifikuar akademik dhe ndihmës akademik me qëllim angazhimit seriozisht në përmirësimin e procesit të mësimdhënies duke patur në qendër studentin.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 2.11. Programi i veprimtarisë kryesore të Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 4.12. Axhenda e trajnimit 4 ditor të Prof.As.Dr. Leticja Gushe me temë: Zhvillimi i kompetencave Pedagogjike</p> <p>Aneksi 4.07.1. Dosja e plote e Workshopit të zhvilluar nga pedagogu amerikan Ronald M Nate</p> <p>Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021</p> <p>Aneksi 4.10. Relacioni dhe axhenda e leksioneve të hapura të zhvilluara në datat 14 janar, 17 janar, 19 janar dhe 24 janar</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmërive dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në Departamentin e Ekonomisë. Ekziston një formular vlerësimi performance, ku performanca e personelit akademik si dhe rezultatet e punës së tyre analizohen në mbledhjet periodike të departamentit si dhe në raportin periodik të NJSBC. Gjithashtu, për t'i ardhur në ndihmë stafit akademik, është marrë vendim nga administratori i shoqërisë për financimin e punimeve shkencore të pedagogëve & pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore apo trajnime,</p>





	<p>por konkretisht dhe praktikisht duhet më shumë nxitje nga drejtuesit, por dhe stafi që të përdoren këto fonde të alokuara.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.36. Formular vlerësimi performance</p> <p>Aneksi 2.35. Vendim i administratorit për veprimtarinë kërkimore shkencore</p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.17. Model Template: Formular i Vlerësimit të Kapaciteteve Njerëzore në fushën akademike dhe kërkimin shkencor 2017-2021</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e KUW, Kreu IX Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, nenet 79-94, & neni 114 për Sekretarinë mësimore; Rregulloren e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi, Kreu II, neni 19 Për metodat, procedurën dhe kriteret e vlerësimit të studentit; Rregulloren e sekretarisë mësimore, neni 2. Përgjithësisht këto dokumenta janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, <i>por GVJ sugjeron që të publikohen të gjitha dokumentat zyrtare (rregullore, etj) në faqen web të IAL KUW.</i></p> <p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive përfshihen dhe në syllabuset e çdo lënde (por konstatohet që te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), syllabuset përmbajnë informacion vetëm për pjesën/modulin e Menaxhimit strategjik & Biznesit ndërkombëtar & Informatikës (dhe nuk përmbajnë informacion për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit), si dhe është krijuar dhe nje formular model me zërat përkatës të vlerësimit të studentëve dhe pikët për çdo zë, për të cilat studentët vihen në dijeni që në momentet e para.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore KUW</p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit</p> <p>Aneksi 1.07. Rregullore e sekretarisë mësimore</p> <p>Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët njihen me mënyrat e vlerësimit dhe testimit nëpërmjet prezantimit të lëndës dhe të syllabus-eve në javën e parë të semestrit nga pedagogët e tyre. Syllabuset e përgatitura nga pedagogët dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomisë, përmbajnë informacion mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive & aftësive profesionale konform VKM përkatës. Mënyrat e vlerësimit përfshijnë detyrat në grup, pjesëmarrjen aktive të studentëve, projektet e kursit, provimet e ndërmjetme, provimet përfundimtare, etj. Gjithashtu, studentëve iu vihen në dispozicion udhëzuesi i didaktikës, si dhe udhëzuesi i praktikës.</p> <p>Konstatim i GVJ:</p> <p><i>Te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), syllabuset përmbajnë informacion vetëm për pjesën/modulin e Menaxhimit strategjik & Biznesit ndërkombëtar & Informatikës (dhe nuk përmbajnë informacion për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 2.16. Model template provimi përfundimtar Aneksi 2.16.1. Model template provimi të ndërmjetem Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit Aneksi 3.10. Programet mësimore Aneksi 3.12. Udhëzues i përgjithshëm i praktikave Aneksi 3.16. Udhëzues didaktik i Programit Menaxhim Biznesi Aneksi 3.05.1. Vendim senati për VKM 41, 2018</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i njohurive dhe aftësive të fituara është vlerësim i vazhduar dhe i shtrirë në kohë, duke u realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të studentëve, detyrave individuale & në grup, projekteve të kursit, provimeve të ndërmjetme, provimeve përfundimtare (praktikisht janë me shkrim të gjitha), ushtrimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete janë të parashikuara në syllabus-et e lëndëve dhe iu komunikohen studentëve që në fillim të semestrit (përveç disa syllabuseve që mungojnë, ku i cituam dhe më lart).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 1.02. Rregullore KUW Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Bazuar tek informacionet e marra gjatë takimit me pedagogët dhe studentët,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>si dhe tek syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale është i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit apo vitit akademik, dhe ky vlerësim përbëhet nga: frekuentimi dhe aktivizimi në leksion apo seminar i studentëve (rreth 10%); provimi i ndërmjetëm (rreth 10%); përgatitja e detyrave të kursit, rasteve studimore apo eseve nga studentët (rreth 10-20%); si dhe provimi përfundimtar (rreth 60-70%); në total 100%; ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale.</p> <p>Ky vlerësim i vazhduar i bën studentët më të përfshirë në gjithë procesin mësimor, kjo në të mirë të procesit si për IAL KUW, ashtu dhe për studentët e saj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW – Kreu IX: Neni 79-94 Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 2.16. Model template: Test provimi përfundimtar Aneksi 2.16.1. Model template: Test provimi i ndërmjetëm Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>IAL KUW ka përdorur platformat Microsoft Teams, Google Classroom/Google Meet dhe Portalin e studentit të KUW për të zhvilluar leksionet dhe seminarat nga ana e personelit akademik, për të realizuar komunikimin pedagog-student, por dhe për vlerësimin e njohurive online/elektronike të studentëve, sidomos në periudhën e pandemisë Covid '19. Përdorimi i këtyre platformave ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimeve në procesin e testimit dhe vlerësimit të studentëve, dhe uljen e ankesave potenciale nga ana e studentëve lidhur me vlerësimin e provimeve të tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.18. Print screen: Portali i studentit Aneksi: RVB i KUW</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Departamentit të Ekonomisë të KUW, GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve, komisione të cilat përbëhen nga dy anëtarë (njëri prej tyre është titullari i lëndës, dhe anëtari i dytë është asistenti/ja). Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me pedagogun që zhvillon seminarat (kur është një rast i tillë), tezë e cila firmoset nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit të Ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë</p>	<p>Bazuar tek informacionet e marra gjatë vizitës në IAL KUW si dhe tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim. Tezat e provimeve sekretohen nga sekretaria mësimore dhe kontrollohen nga</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>pedagogët e lëndës në mënyrë anonime. Provimet nuk zhvillohen asnjëherë pa sekretim, dhe studentët monitorohen në sallë nga pedagogët monitorues, të cilët përpiqen të shmangin tentativat për kopjim nga ana e studentëve në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe i paanshëm për të gjithë studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë: Kreu III</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në takimet e GVJ me studentët, u konstatua që studentët kanë mundësi të marrin komentet dhe vlerësimet e pedagogëve gjatë gjithë kohës, gjë që i ndihmon ata në procesin e të nxënësve dhe përmirësimin deri në provimin përfundimtar. Edhe pasi zhvillohet provimi i ndërmjetëm, pedagogët japin këshilla mbi procesin e të nxënësve apo mënyrën e të mësuarit apo për paqartësi potenciale të studentëve për t'i ndihmuar ata të përmirësohen në të ardhmen. Në provimin përfundimtar, në korrigjimin e tezave të provimit, pedagogët komentojnë pyetjet e realizuara duke dhënë komentet përkatëse që mbështesin vlerësimin total. Në këtë mënyrë sigurohet një përfshirje e plotë e pedagogëve dhe studentëve në proces.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë: Kreu III Aneksi 1.02. Rregullore e KUW: Kreu IX, nenet 79-94</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Gjatë periudhës së zhvillimit të provimeve, studentët monitorohen në sallë nga pedagogët monitorues, të cilët përpiqen të shmangin tentativat për kopjim nga ana e studentëve në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe i paanshëm për të gjithë studentët. Në bazë të rregullores së programit përkatës, për studentët që kryejnë shkelje të tilla, merren masa disiplinore të tilla si Vërejtje me shkrim, Përrjashtim nga studimet për një vit, apo Përrjashtim nga KUW, por deri më tani, nga takimi i GVJ në IAL KUW u konstatua se nuk ka patur raste të tilla.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 3.01. Rregullore e programit: Kreu VI</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga pedagogët e programit të studimit mbahet në konsideratë që teza e provimit të ndërtohet e tillë duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme njohurish nga ato më të thjeshtat deri tek më të vështirat duke i dhënë mundësi studentëve të të gjitha niveleve të arrijnë rezultatin në përputhje me angazhimin e tyre, dhe bazuar në meritokracinë.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata i merrnin në kohë rezultatet e provimeve bazuar në rregulloren përkatëse dhe e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korrigjimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve të provimeve.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 1.02. Rregullore e KUW: Kreu IX</p>




	Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>IAL KUW garanton të drejtat e studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren e Departamentit të Ekonomisë dhe atë të Programit të Studimit BSC në Menaxhim Biznesi, ku përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata njiheshin me elementët e vlerësimit të lëndës që në orën e parë të mësimit, si dhe njiheshin me rezultatet e provimeve, dhe e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korigjimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve të provimeve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 3.01. Rregullore e programit: Kreu V</p>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korigjimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve të provimeve, kurse për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit ankesa i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit brenda 24 orëve nga zhvillimi i provimit (në këtë rast, nëse Përgjegjësi i Departamentit e ka të pamundur të marrë vendim, ia propozon Dekanit për zgjidhje sipas rregullores perkatëse).</p> <p>Çdo kërkesë shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit, dhe nëse studenti nuk është i kënaqur ngrihet një komision tjetër ad-hoc me miratimin e Dekanit. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet në sekretarinë mësimore sipas rregullores.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 1.02. Rregullore e KUW: Kreu IX</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Lidhur me programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, mbështetur tek programet e lëndëve (syllabuset) si dhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të mësimit në këtë program përdoren metoda të cilat janë në funksion të thellimit të njohurive për studentët, ku në leksione merren njohuritë bazë dhe ato më të thelluara, të cilat aplikohen përgjatë seminareve ku studentët zhvillojnë

	<p>aftësitë profesionale, dhe nëpërmjet detyrave të kursit thellohen aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve. Programi i studimit është në përputhje me KSHK (Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve), nivelin nr.VI përsa i përket njohurive që ofron nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe praktikave profesionale.</p> <p>Konstatim i GVJ:</p> <p><i>Te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), syllabuset përmbajnë informacion vetëm për pjesën/modulin e Menaxhimit strategjik & Biznesit ndërkombëtar & Informatikës (dhe nuk përmbajnë informacion për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.04. Planet mësimore për tre vitet e fundit Aneksi 3.05. Veprimtari formuese të programit Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 2.09. Studimi periodik i tregut i programit Bachelor në Menaxhim Biznesi</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar tek planet mësimore, programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi ka si qëllim të përgatisë profesionistë me njohuri dhe aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit përmes lëndëve të tilla si: Teknologji informacioni, Komunikim në biznes, Sjellje organizative, Gjuhë e huaj angleze, etj. Idea është që studentët të pajisen me njohuri kryesisht në fushën e ekonomisë, por dhe të teknologjisë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 3.04. Planet mësimore për tre vitet e fundit</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i marrë në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të programit dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, GVJ u informua që syllabuset e lëndëve diskutohen në mbledhjet e departamentit çdo vit me qëllim përmirësimin e tyre në aspektin e përmbajtjes dhe të metodologjisë, dhe për të sjellë zhvillimet e fundit në fushën përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, stafi akademik harton Relacionin e Lëndës në përfundim të çdo lënde/moduli ku vlerëson, analizon dhe shqyrton aftësitë e fituara nga studentët, si dhe analizohet në mënyrë të përgjithshme realizimi i lëndës, problematikat e hasura, përmirësimet potenciale, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>

	<p>Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</p> <p>Aneksi 2.19.5. Model template - Relacion semestral i programit të lëndës</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të aktiviteteve të përcaktuara në programin e lëndës, kompetencat dhe aftësitë që ka fituar studenti testohen nëpërmjet detyrave të kursit, ose testimeve me shkrim.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde pedagogu bën përmbledhjen e të gjithë çështjeve kryesore dhe orienton studentët për tu përgatitur për provimin përfundimtar, si dhe gjatë sezonit të provimeve studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët e tyre për paqartësi potenciale lidhur me tema të ndryshme.</p> <p>Gjithashtu, në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik harton Relacionin e Lëndës ku vlerëson, analizon dhe shqyrton aftësitë e fituara nga studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</p> <p>Aneksi 2.19.5. Model template - Relacion semestral i programit të lëndës</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua që IAL KUW organizon leksione/seminare të hapura (psh. temat lidhur me politikën monetare dhe fiskale; bursa në kohë pandemie; tregu i punës gjatë pandemisë; ekonomia post covid '19; sfidat e ekonomisë, etj) me specialistë të mirënjohur të fushës së teknologjisë së informacionit apo ekonomisë, për të sjellë të reja të shkencës apo teknologjisë në shërbim të pasurimit të njohurive që marrin studentët në këtë program studimi, dhe për secilin nga këto seminare/leksione të hapura hartohen dhe relacionet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.11. Programi i veprimtarisë kryesore të Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021</p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.10. Relacioni dhe axhenda e leksioneve të hapura të zhvilluara në datat 14 janar, 17 janar, 19 janar dhe 24 janar</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në bazë të llojit të programit të studimit të ofruar nga IAL KUW, si dhe tek syllabuset e lëndëve, planin mësimor, apo edhe eksperiencën e stafit akademik të këtij programi studimi, mund të themi që mësimdhënia realizohet mbi bazën e aplikimit në laborator për ato lëndë/module specifike, të njohurive të marra në leksione dhe seminare. Mënyra e zhvillimit të mësimin të përshtatet natyrës së lëndës/modulit dhe ofron zhvillim kompetencash nëpërmjet detyrave të kursit të studentëve.</p>

	<p>Gjithashtu, praktikat e studentëve zhvillohen pranë kompanive të ndryshme private në vend në bazë të marrëveshjeve të hartuara nga IAL KUW me këto kompani.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.11. Vendim për institucionet dhe tutorët e praktikave Aneksi 3.11.1. Relacion për praktikat e studentëve MB</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit, u informua që personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi apo projekte kurse që lidhen me punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke simuluar raste/problematika reale të hasura nga kompanitë në aktivitetin e tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i Departamentit për materiale didaktike Takimi me stafin akademik të IAL</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit, u informua që personeli akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, duke i mbështetur ata në pjesëmarrjen në studime të avancuara kërkimore konferenca, konkurse apo aktivitete të tjera.</p> <p>Sipas pedagogëve të këtij programi studimi, synohet që të përmirësohet mësimdhënia dhe të vihet studenti në qendër, pra mbështetje të tyre në çdo nisëm apo ide që duan të ndërmarrin. Studentët kanë mundësinë të përdorin bibliotekën fizike dhe atë online në projekt idetë e tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i Departamentit për materiale didaktike Aneksi 1.20. Të dhëna platforma online, struktura TIK, etj</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me drejtuesit dhe studentët, u konstatua që mbështesin zhvillimin e ideve inovative nga ana e studentëve, si dhe me vendim akordohet dhe një fond i posaçëm për aktivitete të ndryshme studentore. Gjithashtu, studentët nxiten të marrin pjesë në projekte shkëmbimi Erasmus+, etj.</p> <p>Studentët kanë mundësinë të përdorin bibliotekën fizike dhe atë online në projekt idetë e tyre.</p> <p><i>Ekziston një vendim i administratorës, por duhej më shumë informacion mbi materializimin (aplikimin në praktikë) e vendimit të administratorës për ide konkrete, inovative të studentëve, etj.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p>




	Aneksi 2.35.1. Vendim i administratores 'Për mbështetjen e Këshillit Studentor 21-22'			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>IAL K UW në bashkëpunim me Personelin akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucione të ndryshme që ka marrëveshje bashkëpunimi për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Kështu, disa studentë të caktuar kanë marrë pjesë në workshope apo shkëmbime Erasmus+ në Kroaci, Rumani, Bosnjë Hercegovinë.</p> <p><i>GVJ mendon që duhen më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.01.1. Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.01.2. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2017-2019</p> <p>Aneksi 4.04.1. Marrëveshjet e bashkëpunimit</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>IAL K UW harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Modalitetet dhe procedurat për zhvillimin e provimeve finale përcaktohen në rregulloret përkatëse, konkretisht në atë të Departamentit të Ekonomisë në nenin: Vlerësimi i Dijes (dhe nenet në vijim pas këtij seksioni).</p> <p>Kurse diploma mbrohet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me temë diplome, ku modalitetet dhe procedurat për të përcaktohen në rregulloret përkatëse, konkretisht në atë të Departamentit të Ekonomisë në seksionin: Përfundimi i studimeve dhe diplomimi. Nga takimi me drejtues te IAL, u konstatua nga GVJ që deri më tani studentët që përfundojnë studimet BSc në Menaxhim Biznesi, diplomën e mbrojnë me provim të përgjithshëm (mbrojnë me temë diplomë studentët që deri në semestrin e pestë kanë mesatare 8.5 e më lart ... sipas RVB të IAL K UW). <i>GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë për mbrojtjen e diplomës nga studentët me notë mesatare 8.5 e lart, si dhe që rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore është e paplotë ... mungojnë faqe (aneksi 2.06).</i></p>




	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.06. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat e mbrojtjes së temave të diplomës</p> <p>RVB e IAL KUW (standardi III.8; kriteri 1)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse, konkretisht Departamenti i Ekonomisë dhe stafi akademik asiston studentët për përgatitjen për provimin e përgjithshëm përfundimtar duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të këtij provimi (ose diplomës për studentët që plotësojnë kriterin e mesatares), dhe datat shpallen sipas një grafiku të miratuar nga dekani.</p> <p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar është gjithpërfshirës, dhe mbulon tema të fushave kryesore të programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi të zhvilluara përgjatë tre viteve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat e mbrojtjes së temave të diplomës</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Dekani në bashkëpunim me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë përpara fillimit të semestrit të VI të studimeve, iu bën me dije studentëve që nuk kanë arritur nivelin e përcaktuar të mesatares, programin e provimit përfundimtar, provim i cili bazohet në lëndët/modulet bazë, si dhe në lëndët specifike.</p> <p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit është i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm që mbulojnë programin e studimit. Teza e provimit përmban pyetje të të gjitha fushave që përfshin programi në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Sipas RVB, standardi III.8, kriteri 1, “për kryerjen e detyrimeve finale është parashikuar punim diplome për studentët me mesatare mbi 8.5 dhe provim final për pjesën tjetër të studentëve”. <i>GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë.</i></p> <p>Por nga takimi me studentët, u konstatua që personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e</p>	<p>Për studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL u konstatua që këto nuk janë të</p>

<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>aplikueshme praktikisht deri më tani për studentët BSc, meqënëse deri tani kanë funksionuar me provim të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Sipas RVB, standardi III.8, kriteri 1, “për kryerjen e detyrimeve finale është parashikuar punim diplome për studentët me mesatare mbi 8.5 dhe provim final për pjesën tjetër të studentëve”. <i>GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë. Në rregulloren e Departamentit të Ekonomisë specifikohet që studentët mund të japin provim formimi ose të bëjnë punim diplome.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL u konstatua që këto nuk janë të aplikueshme praktikisht deri më tani për studentët BSc, meqënëse deri tani kanë funksionuar me provim të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Sipas RVB, standardi III.8, kriteri 1, “për kryerjen e detyrimeve finale është parashikuar punim diplome për studentët me mesatare mbi 8.5 dhe provim final për pjesën tjetër të studentëve”. <i>GVJ konstaton se nuk ka asnjë vendim që përmban ndonjë informacion të tillë. Në rregulloren e Departamentit të Ekonomisë specifikohet që studentët mund të japin provim formimi ose të bëjnë punim diplome.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit (ose mbrojtjes së diplomës), studentët vlerësohen me note nga 4-10 (sipas RVB, standardi III.8, kriteri 7 ... <i>kjo gjë duhet të specifikohet më qartë dhe në rregulloren përkatëse të Departamentit të Ekonomisë?!).</i></p> <p>Vlerësimi bëhet nga komisioni i posaçëm për administrimin e provimit, i cili është i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm që mbulojnë programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat e mbrojtjes së temave të diplomës</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, nëse studenti ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me temë ose provim formimi) pajiset me diplomë të shoqëruar me suplementin përkatës (sipas Rregullores së programit), të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>




	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 3.13. Suplementi i Diplomes Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 3.14. Model Diplome Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat e mbrojtjes së temave të diplomës</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studentit i vihet gjithashtu në dispozicion edhe një kopje zyrtare e plotë e programit të studimit BSC në Menaxhim biznesi të ofruar nga IAL KUW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e programit Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 3.13. Suplementi i Diplomës Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 3.14. Model Diplome Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat e mbrojtjes së temave të diplomës</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria mësimore mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar. Nga informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore, GVJ u informua që institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi (përgjithmonë, informacion dhe të dhëna që më pas kalohen nga Sekretaria mësimore për në Arkivë). Sipas Rregullores së institucionit dhe sekretarisë informacionet për studentin mund të vihen në dispozicion të të interesuarve duke proceduar rast pas rasti.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.07. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (Rregullore e ZBNJKKJS; Rregullore e KUW) si dhe vizitën në IAL KUW, GVJ konstaton se zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL KUW. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik efektiv, atë me kontratë dhe atë administrativ, të dhëna të cilat mbliidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë në fuqi.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL KUW, në takimim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, GVJ konstatoi që kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar, si dhe një pjesë të tyre në formë elektronike. GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Këto dosje përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: CV, dokumentin e identifikimit, pozicionin e punës, diplomat, gradat dhe titujt shkencorë, kontratën e punës, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, etj. Kanë dhe mjek në institucion, i cili ka hapur kartelë mjekësore për çdo person të punësuar në IAL.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se informacioni për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Ekonomisë përgjegjës për programin e studimit BSc në Menaxhim Biznesi.</p> <p><i>Zyra e Burimeve njerëzore është bashkë me Këshillimin e Karrierës. GVJ sugjeron që duhet të jenë në vete si dhe rregullorja e BNj është e 'thatë' dhe duhet më e zgjeruar.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW i harton procedurat e rekrutimit të personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH' dhe mbështetur në dokumentat e brendshme të institucionit: Statuti i KUW, Rregullorja e KUW, dhe dokumentave mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Personelit Akademik. Në këto dokumenta janë përcaktuar: kërkesat e përgjithshme dhe specifike për të qenë punonjës i IAL KUW, procedurat e përzgjedhjes së kandidatit, shpallja dhe procesi i konkurimit, mënyra e vlerësimit (me dosje dhe intervistë), etj. Procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, e cila i bën ato publike. Kriteret përcaktohen nga Departamenti i Ekonomisë dhe miratohen nga Dekani; më pas bëhet shpallje publike për vendin e lirë dhe ngrihet komision vlerësimi Ad-Hoc që ndjek procedurën deri në fund bashkë me përfaqësuesin e zyrës së BNj.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ u njoh me këto procedura nëpërmjet</p>




	<p>përfaqësueses së zyrës së Burimeve Njerzore si dhe në takimin me personelin dhe drejtuesit e IAL, dhe konstatoi se këto procedura janë të hapura dhe transparente.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 2.24. Politika të rekrutimit Aneksi 2.24.1. Procedura rekrutimi</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullore dhe i bën ato publike.</p>	<p>IAL në fillim të vitit akademik publikon nevojat, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. GVJ konstaton që kërkesat për personel akademik vijnë nga Departamenti i Ekonomisë, bazuar tek planet mësimore dhe ngarkesa mësimore, të cilat miratohen nga Dekani. Kriteret specifike/të posaçme për personelin akademik për këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Ekonomisë me miratim të Dekanit. Zgjedhja e anëtarëve të komisionit ad-hoc, (personel me përvojë në departamente) bëhet me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit. Këto kritere kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit. Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent dhe objektiv.</p> <p>Njoftimet për vendet e lira shpallen në faqen e web-it të IAL, në ambiente të dukshme në IAL dhe në internet, njoftime të cilat përmbajnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve të lira të shpallura.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 2.24. Politika të rekrutimit Aneksi 2.24.1. Procedura rekrutimi Aneksi 2.23.1. Kriteret të kokurimit personel akademik</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>IAL KUW i zhvillon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në përputhje legjislacionin në fuqi, me dokumentat mbi Politikën dhe Procedurat e Rekrutimit të Personelit Akademik (që përcaktojnë procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, mënyrën e shpalljes dhe realizimit të konkursit, si dhe mënyrën e vlerësimit), si dhe përcaktimet në Rregulloren e KUW & Statutin e KUW. Për të gjitha kategoritë e rekrutimit të stafit ngrihen komisione ad-hoc (të përbërë nga anëtarë me përvojë të departamenteve), rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të të cilit caktohen në aktet e brendshme të IAL KUW. Këto komisione kanë kryesisht pesë anëtarë (ku njëri anëtar zgjidhet kryetar), nga të cilët 1 përfaqësues i Dekanatit, 1 përfaqësues i Rektoratit dhe 3 përfaqësues nga departamenti me të cilën lidhet kërkesa për vendin e lirë të punës. Në përgjithësi procesi i rekrutimit kalon në këto faza: publikohen vendet e lira në faqen e web-it të IAL KUW me kriteret e përgjithshme dhe specifike ku lihet afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentave nga</p>




	<p>aplikantët, bëhet përzgjedhja e kandidaturave që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike, dhe intervistohen kandidatët nga komisioni ad-hoc i ngritur specifikisht në përputhje me vendin e lirë; vlerësimi final i çdo kandidati përbëhet nga pikët e dosjes dhe pikët nga intervista, ku në fund kandidatët renditen nga ai me pikët më të larta te ai më pikët më të ulëta. Gjatë vizitës në IAL, GVJ u njoh me disa dosje të procedurave të rekrutimit të personelit pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dhe konstatoi se këto procedura janë ndjekur për të gjithë stafin e rekrutuar.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 2.24. Politika të rekrutimit Aneksi 2.24.1. Procedura rekrutimi</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ vizitoi në vend dhe u njoh me mjediset & kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ në IAL KUW. Mjediset ku zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi kanë një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Mjediset janë të tilla që ofrojnë kushte të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të IAL KUW. Mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit, si kompjutera, projektorë, etj., si dhe mbulohen nga rrjeti wireless që ofron internet për stafin dhe studentët. Staf i akademik ka akses në bibliotekën fizike të IAL si dhe atë online ProQuest për t’ju ardhur në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë kërkimor shkencor.</p> <p><i>GVJ sugjeron që tek auditorët të mbyllet pjesa lart e mureve (janë të hapura) sepse krijon probleme/konfuzion/zhurma kur zhvillohet mësim në shumë salla njëkohësisht.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura Aneksi 2.29. Kontratë qeraje</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe</p>	<p>Gjatë takimit në IAL KUW me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ u informua se</p>

Adresa: "Ruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>IAL KUW ofron angazhimin e tij për t'i dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm. Kështu, atyre iu mundësohet publikimi i artikujve shkencorë në revistën shkencore 'Wisdom'. Institucioni mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. GVJ konstaton gjithashtu se KUW përpiqet të mbështesë personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore, ku ekziston dhe një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për vitin akademik 2021-2022, <i>por duhet theksuar që duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.08.1. Model mbështetjeje pedagogu</p> <p>Aneksi 2.35. Vendim i administratorit për veprimtarine kërkimore shkencore</p> <p>Aneksi 4.11. Relacion mbi leksionin e hapur të zhvilluar nga lektori Schuman me temë Përcaktimi i çmimeve të produkteve dhe shërbimeve</p> <p>Aneksi 4.11.1. Relacion mbi leksionin e hapur të zhvilluar nga lektori Sung Huin Kun me temë Mind Education</p> <p>Aneksi 4.15. Relacion mbi leksionin e hapur Dr. Marija Stojanova</p> <p>Aneksi 4.15.1. Relacion Mbrojtja e mjedisit dhe sfidat e një ekonomie qarkulluese – Axhenda e visiting profesor Dr. David Kolbe</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, me përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, GVJ u informua që IAL në bashkëpunim më Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënies me Jashtë nxit dhe mbështet zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimin e teknologjive të reja. Kjo mbështetje konsiston jo vetëm në ofrimin e mundësive për mobilitete dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore me partnerë të huaj të stafit akademik, por edhe në ofrimin e trajnimeve në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, GVJ konstaton se trajnimet e stafit kanë konsistuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione/seminare të hapura nga lektorë të huaj, psh. workshopi me temë: An economic's professor's approach to teaching a difficult subject, me profesorin R. M. Nate; - Trajnime/seminare për shkrimin dhe aplikimin në projekte të ndryshme të kërkimit shkencor; - Etj.






	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.09. Vendim i Departamentit për materiale didaktike Aneksi 4.07.1. Dosja e Plotë e Workshopit të zhvilluar nga pedagogu amerikan Ronald M. Nate</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në IAL KUË, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore si dhe Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM nr.418, 10.05.2017 - PËR STANDARDET, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN, NDARJEN, BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E IAL DHE TË DEGËVE TË TYRE; dhe nivelin e kualifikimit të stafit).</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi janë angazhuar 12 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK). Kurse, Departamenti i Ekonomisë përbëhet nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 1 pedagog i jashtëm dhe raporti i mësimdhënies është 88.9% PAE dhe 11.1% PAK, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr. - 1 Prof. Asoc. Dr. - 4 Dr. - 1 proces Dr - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 1 pedagog me titull shkencor Prof. Asoc. Dr.</p> <p>Konstatohet që mjaft titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc ... sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.09. Te dhenat e plota te kualifikimit dhe kerkimit shkencor te stafit akademik ne 5 vitet e fundit Aneksi 2.21.1. Personeli akademik BMB</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e IAL KUW dhe konstatoi, bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës, se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në një ambient (i marrë me qera deri në mesin e vitit 2026) të pozicionuar përgjatë autostradës Tiranë-Durrës, që ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</p> <p>Në mjediset e KUW gjenden sallat/auditoret e leksioneve, të seminareve, një laborator informatike dhe biblioteka.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura Aneksi 2.29. Kontratë qeraje</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mbështetur tek vizita në mjediset e IAL KUW dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se klasat/auditoret janë të pajisura me kompjuter (për pedagogun) dhe videoprojektor, dhe me lidhje interneti që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik.</p> <p>Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>IAL KUW disponon 1 laborator informatike (me 22 poste) në funksion të programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi (rreth 20-30 studentë çdo vit), të pajisur me PC për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë. Përveç programeve që lidhen me fushën e Informatikës, studentët përdorin në laborator edhe programe që lidhen me lëndë të tjera të tilla si ato të Financës, Kontabilitetit, etj. E gjithë infrastruktura e rrjetit kompjuterik mirëmbahet nga departamenti i IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike.</p> <p>GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat/auditoret, laboratorit, etj) të IAL KUW janë në mbështetje të realizimit të objektivave të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura Aneksi 1.17. Udhëzues për monitorimin e STI</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së</p>	<p>IAL KUW disponon 1 laborator informatike (me 22 poste) në funksion të programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi (rreth 20-30</p>

<p>informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>studentë çdo vit), të pajisur me PC për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë. Përveç programeve që lidhen me fushën e Informatikës, studentët përdorin në laborator edhe programe që lidhen me lëndë të tjera të tilla si ato të Financës, Kontabilitetit, etj. E gjithë infrastruktura e rjetit kompjuterik mirëmbahet nga departamenti i IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.28. Planimetria & infrastruktura</p> <p>Aneksi 1.17. Udhëzues për monitorimin e STI</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit si dhe nga informacioni që GVJ mori në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë si dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, konstatohet që IAL KUW ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit publik dhe privat, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi, psh. marrëveshjet me Alba Beton shpk, me Concord shpk, me Europa Caffè, me Edil-al, me Albeton 5, Happy group shpk, etj.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi, praktika profesionale/mësimore është 150 orë, ku studenti i realizon pranë institucioneve me të cilat IAL KUW ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe disa orë mund të përdoren gjithashtu edhe në ambientet e KUW.</p> <p>GVJ konstaton se IAL i ofron studentëve të gjitha mundësitë për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4.03. Tabelat përmbledhëse dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione</p> <p>Aneksi 4.04.1. Marrëveshjet e bashkëpunimit</p> <p>Aneksi 3.04. Planet mësimore tre vitet e fundit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë</p>	<p>GVJ vizitoi bibliotekën e IAL KUW, të vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka është njësi ndihmëse e IAL dhe ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës së KUW, e cila ofron mundësi aksesit për</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




nga studentët e programit të studimit.	<p>të gjithë studentët dhe stafin. Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbase nga dita e hënë në të premten, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo rezervimeve të studentëve. Sipas drejtuesve të IAL, studentët kanë të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogut elektronik online 'Cobiss'.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 1.08. Rregullore e bibliotekës</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj rreth 270 libra fizikë për fushën e ekonomisë, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. <i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Menaxhim biznesi.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e Ku Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë shtuar vitet e fundit Aneksi 2.20.1. Propozim nga Departamenti i Ekonomisë për blerjen e titujve të nevojshëm në Bibliotekë 2021-2022 Aneksi 2.20.2. Vendim Dekani i FSHEHSH për blerjen e titujve në Bibliotekë 2021-2022 Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 1.20. Të dhëna platforma online, struktura TIK etj</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës së IAL KUW, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar & takimi me studentët, GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës që institucioni ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online, psh. në atë ProQuest në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat që kërkon stafi dhe studentët, si dhe u konstatua që kushtet për akses janë të barabarta e pa pagesë për studentët në aksesimin e bibliotekës on-line.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.20. Të dhëna platforma online, struktura TIK etj Aneksi 2.38. Pagesa ProQuest janar 2022</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Në bibliotekën e IAL KUW janë të instaluar 12 laptopë (me programe kompjuterike) që iu jep studentëve mundësinë e shfrytëzimit pa kufizime, <i>megjithatë GVJ konstaton se numri i tyre është i vogël dhe sugjeron shtimin e kompjuterave/laptopëve në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></p>

	<i>Evidenca:</i> Aneksi 2.28. Planimetria & Infrastruktura			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Në bazë të RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL KUW, GVJ u informua që KUW parashikon fonde çdo vit për shtimin e literaturës në bibliotekë, konkretisht për vitin 2021-2022 janë miratuar blerjet e librave përkatës të parashikuar nga departamenti i ekonomisë (për të plotësuar në këtë mënyrë bibliotekën fizike). <i>Evidenca:</i> Aneksi 2.20. Relacion për Bibliotekën e Ku Wisdom. Bashkëngjitur lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë shtuar vitet e fundit Aneksi 2.20.1. Propozim nga Departamenti i Ekonomisë për blerjen e titujve të nevojshëm në Bibliotekë 2021-2022 Aneksi 2.20.2. Vendim Dekani i FSHESH për blerjen e titujve në Bibliotekë 2021-2022			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në bibliotekën e IAL KUW dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve nga ora 8.30 deri në orën 19.30 nga e hëna në të premten. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një hapësirë të gjerë orari (paradite, drekë dhe pasdite), pa cënuar orarin e zhvillimit të procesit mësimor. <i>Përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka e IAL KUW, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë.</i> <i>Evidenca:</i> Aneksi 1.08. Rregullore e bibliotekës			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore të IAL KUW, GVJ u informua se informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim administrohet nga Sekretaria Mësimore (bazuar tek Rregullorja e Sekretarisë Mësimore). Sekretaria mësimore administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët, të dhënat personale të tyre, notat, etj, në formën e regjistrave fizikë dhe në mënyrë elektronike. GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në IAL KUW dhe dosjet personale të studentëve, dhe zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra studentësh të

	<p>programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi dhe konstatoi që të gjithë të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt nga ana e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.07. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL KUW, zyrë e cila i mban të dhënat e personelit akademik, atij ndihmës akademik, dhe personelit administrativ & partnerëve të angazhuar në realizimin e programit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditësohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta të tilla si CV-të e personelit (për personelin akademik ajo shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore); pozicioni i punës; diplomat & gradat/titujt shkencorë; fotokopje të dokumentit të identifikimit dhe adresës së vendbanimit; formular vetëdeklarimi apo dëshmi penaliteti; kualifikime të tjera / informacione shtesë, etj.</p> <p><i>GVJ konstaton që Zyra e Burimeve Njerëzore është bashkë me Këshillimin e Karrierës dhe sugjeron që duhet të jenë në vete, si dhe rregullorja e BNj është e 'thatë' dhe duhet më e zgjeruar.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me ligjin e privatësisë bëhet akses i tek informacioni dhe dokumentacioni për gjithë personelin dhe studentët. Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL KUW, si dhe të aksesojnë Portalin e Studentit me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi stafi akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj dhe shërben si mënyrë komunikimi pedagog-student.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.18. Politika institucionale e publikimit</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL KUW, si dhe të aksesojnë Portalin e Studentit me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi personeli akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Stafi akademik mund të ngarkojë leksionet dhe</p>




	<p>materialet te opsioni: Materialet e pedagogut; si dhe është opsioni: Forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit.</p> <p><i>Evidenca:</i> http://portal.hstalb.xyz/</p>								
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nëpërmjet faqes web të IAL dhe Portalit të Studentit mund të shkëmbehet informacion midis pedagogëve dhe studentëve, si dhe aksesim nga studentët për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor.</p> <p>Gjithashtu, komunikimi ndërmjet të gjithë palëve në proces në KUW realizohet nëpërmjet postës elektronike me adresat e email-it të domain-it: www.wisdom.edu.al. Përveç faqes së web-it të KUW, formë tjetër komunikimi janë edhe platformat e ndryshme të rrjeteve sociale, nëpërmjet të cilave bëhet komunikimi jo vetëm midis stafit dhe studentëve, por edhe shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në KUW.</p> <p><i>Por një sistem informacion të mirëfilltë menaxhimi akoma nuk ka, psh. notat hidhen manualisht nga pedagogët, jo nga sistemi.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> http://portal.hstalb.xyz/ Takimi në IAL KUW</p>								
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga GVJ konstatohet që informacionet që lidhen me programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, informacioni mbi aktivitetet e ndryshme & informacione të tjera që lidhen me IAL KUW, gjenden dhe në faqen e web-it https://wisdom.edu.al, të cilat publikohen në dy gjuhë: gjuhën shqipe dhe atë angleze. Përveç faqes së web-it, KUW i publikon informacionet e veta dhe i ndan me publikun edhe në kanale të tjera të informimit dhe median sociale.</p> <p><i>Sugjerohet që në faqen web të IAL KUW të përfshihet më shumë informacion për stafin akademik (informacion i cili mungon) të përfshirë në programin e studimit, bashkë me CV-të e tyre, gjë që tregon transparencë.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 1.21. Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it Faqja web www.wisdom.edu.al</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1780 794 1848">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="794 1780 981 1848">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="981 1780 1216 1848">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1216 1780 1449 1848">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							




Standardi IV.6**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, GVJ konstaton se IAL KUW harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit që ai ofron në nivel institucional ku pasqyrohen të ardhurat (nga fee-të e studentëve, nga dhënie ambientesh me qera, nga projektet, etj) dhe shpenzimet (operative, administrative, etj). Gjithashtu përgatitet buxheti nga administratori në përputhje me parashikimet ligjore, Statutin dhe Rregulloren e KUW, buxhet i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Departamentet e IAL KUW paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, të cilat pas miratimit në nivelet përkatëse përcillen në departamentin e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të IAL si një njësi e vetme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.31. Projekt buxheti 2021-2022</p> <p>Aneksi 2.33. Të ardhurat dhe financimet</p> <p>Aneksi 2.33.2. Pasqyrat Financiare</p>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>Plani i financimit të programeve të studimit përmban zëra të tillë si financimi i burimeve njerëzore, shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim & zhvillim, shpenzimet për mirëmbajtjen, shpenzimet për bibliotekën, etj. Nga drejtuesit e IAL KUW është vënë si objektiv rritja e të ardhurave nga projektet e ndryshme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.31. Projekt buxheti 2021-2022</p> <p>Aneksi 2.33. Të ardhurat dhe financimet</p> <p>Aneksi 2.33.2. Pasqyrat financiare</p> <p>RVB e IAL KUW</p> <p>Aneksi 4.01.1 Raport i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.01. Raport Vjetor i Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marredhenieve me Jashtë 2018-2021</p> <p>Aneksi 4.13. Kontratë midis pedagogeve të programit Bachelor në Menaxhim dhe Institutit për Kërkim dhe Zhvillim Wisdom</p>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë	<p><i>GVJ konstaton se në të dhënat e ngarkuara në sistem mungon një raport audit i ligjor i pavaruar që vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të IAL, dhe ku të paraqiteshin në mënyrë të hollësishme analiza në lidhje me të ardhurat dhe kostot për studentët duke argumentuar edhe</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p><i>përputhjen e performancës financiare të KUW në lidhje me standardet kontabël të miratuara.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.31. Projekt buxheti 2021-2022</p> <p>Aneksi 2.33. Të ardhurat dhe financimet</p> <p>Aneksi 2.33.2. Pasqyrat financiare</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUW dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron.</p> <p>Sipas drejtuesve të IAL KUW, në bazë rezultateve të raporteve paraardhëse parashikohen ndërhyrje në buxhetin pasardhës që miratohet nga bordi i administrimit, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga departamentet apo njësitë kryesore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.31. Projekt buxheti 2021-2022</p> <p>Aneksi 2.33. Të ardhurat dhe financimet</p> <p>Aneksi 2.33.2. Pasqyrat financiare</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitetë financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL KUW, ata shprehen mjaft entuziastë për ecurinë e KUW dhe kanë si objektivi rritjen e të ardhurave nga projektet, krahas atyre nga fee-të e studentëve, apo mënyrave të tjera.</p> <p><i>Por duhet thënë që nevojitet dhe një raport auditi ligjor i pavaruar që vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të IAL për të dëshmuar më qartë se IAL garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.31. Projekt buxheti 2021-2022</p> <p>Aneksi 2.32. Tarifat e studimit 21-22</p> <p>Aneksi 2.33. Të ardhurat dhe financimet</p> <p>Aneksi 2.33.2. Pasqyrat financiare</p> <p>Aneksi 2.34. Propozim Miratimi i fondit të kërkimit shkencor '21-'22</p> <p>Aneksi 2.35. Vendim i administratorit për veprimtarinë kërkimore shkencore</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me Statutin e KUW, Rregulloren e KUW, Rregulloren e programit, si dhe në përputhje me me ligjin nr.80/2015, udhëzimin e MASR, nr.10, datë 15.05.2019, si edhe Udhëzimin e MASR, nr.17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.01. Rregullore e Programit</p> <p>Aneksi 2.15. Vendim Rektori - Për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021</p> <p>Aneksi 2.15.1. Vendim Senati - Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit 2019-2020, 2020-2021</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se politikat dhe procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në Rregulloren e KUW, neni 61, që përcakton të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga IAL KUW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjithshtu, nga vizita në strukturat përkatëse në IAL KUË dhe takimin me studentët, GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet kanaleve të ndryshme formale të komunikimit. Këto procedura kryhen në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL KUË, si dhe ligjin nr.80/2015 Për arsimin e</p>




	<p>lartë dhe kërkimin shkencor në RSH (psh. kriteret për përfundimin e shkollës së mesme, si dhe nota mesatare sipas ligjit në fuqi, etj). Krahas propozimit për kuotat e pranimit, secili departament përgatit dhe propozimin për kriteret të veçanta të programit të studimit. Ose, psh procedura për transferimin e studentëve është e tillë që studenti që dëshiron të transferohet nga një IAL publike apo private në IAL KUË, duhet të paraqesë: kërkesën me shkrim drejtuar IAL KUË për programin e studimit në të cilin do të transferojë studimet; planin e plotë të programit të studimit nga IAL që transferohet përfshirë dhe syllabuset përkatëse nëse IAL KUË nuk i disponon; vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur; fotokopje të noterizuar të dëftësës së pjekurisë të shkollës së mesme; fotokopje të dokumentit të identifikimit; dy fotografi personale; kopje të mandatit të pagesës. Vlerësimi i përcillet dekanit të fakultetit, i cili vendos brenda afateve ligjore pranimin ose jo të kërkesës së studentit. Kurse, nëse studenti dëshiron të transferohet nga IAL KUË në një IAL tjetër, duhet t'i paraqesë dekanit të fakultetit përkatës të paktën 10 ditë përpara kërkesën me shkrim për transferim, ku duhet të bëjë të njohur dhe emrin e IAL ku kërkon të transferohet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti KUË Aneksi 2.37. Rregullore e transferimeve Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 2.15.1.Vendim Senati - Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit 2019-2020, 2020-2021 Aneksi 1.07. Rregullore Sekretaria Mësimore</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit Bachelor në Menaxhim biznesi tek KUË propozohen nga njësia kryesore dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të KUË, vendime të cilat i dërgohen më pas MASR. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se kriteri bazë i pranimit për programin BSc në Menaxhim biznesi është diploma e shkollës së mesme dhe mesatarja e shkollës së mesme & provimet e maturës shtetërore (që përcaktohet çdo vit nga MASR ... kriter që zë 40% të pikëve); mesatarja e lëndëve Ekonomi, Matematikë, Gjuhë e huaj (që zë 40% të pikëve); dhe intervista e kandidatëve (që zë 20% të pikëve). Senati akademik i KUË miraton përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta në përputhje me nenin 45 të Rregullores së KUË, kriteret të cilat publikohen në fillim të çdo viti akademik, por për vitin akademik 2021-2022 kriteret bazë të pranimit janë ato të sipërcituara (pra nuk ka të tjerë kriteret ekstra).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.15.1.Vendim Senati - Mbi miratimin e kuotave të pranimit të</p>




	<p>studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit 2019-2020, 2020-2021</p> <p>Aneksi 2.15. Vendim Rektori - Për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUË</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të MASR, si dhe në maturën shtetërore. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se kriteri bazë i pranimit për programin BSc në Menaxhim biznesi është diploma e shkollës së mesme dhe mesatarja e shkollës së mesme & provimet e maturës shtetërore (që përcaktohet çdo vit nga MASR ... kriter që zë 40% të pikëve); mesatarja e lëndëve Ekonomi, Matematikë, Gjuhë e huaj (që zë 40% të pikëve); dhe intervista e kandidatëve (që zë 20% të pikëve). Nga vëzhgimi i dokumentave, kriteret nuk parashikojnë regjistrimin e studentëve të huaj, apo të trojeve, apo me aftësi të kufizuara & me status jetimi, gjë që sipas mendimit të GVJ duhet të parashikohen në të ardhmen.</p> <p><i>Duhet thënë që ky kriter është keqkuptuar nga GVB në përgjigjen që ka dhënë (duhej apo duhet informacion më i plotë).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.15.1. Vendim Senati - Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit 2019-2020, 2020-2021</p> <p>Aneksi 2.15. Vendim Rektori - Për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021</p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik IAL KUW realizon takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacione nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi. Në periudha të caktuara KUW merr pjesë në panairë ku marrin pjesë dhe IAL të tjera, apo organizon dhe ditët e informimit me maturantët. Për më shumë informacion, çdo i interesuar mund të aksesojë dhe Guidën e Studentit në faqen web të IAL: www.wisdom.edu.al.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.26. Panairi Work & Study</p> <p>Aneksi 3.15. Guida e studentit</p> <p>Aneksi 3.16. Udhëzues Didaktik i Programit Menaxhim Biznesi</p> <p>Aneksi 3.17. Relacion për pjesëmarrjen KU Wisdom në ditët e informimit të maturantëve</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, si dhe në takimin me studentët, GVJ konstaton që IAL KUW informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Nëpërmjet sekretarisë mësimore studentët marrin informacion të rëndësishëm në lidhje me procesin mësimor, orarin, detyrimet akademike, provimet, etj. Në fillim të çdo semestri dhe për çdo lëndë/modul, pedagogët iu prezantojnë studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, etj.</p> <p>Gjithshtu, informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara dhe në Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.08. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë Aneksi 3.01. Rregullore e Programit</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në bazë të Statutit, neni 69, dhe Rregullores së transferimeve, si dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton se studentëve iu vihet në dispozicion informacion i plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në rast transferimi këto procedura përfshijnë vlerësimin e dosjes së studentit nga një komision që shqyrton dosjen dhe e vlerëson atë për të ekuivalentuar kreditet në përputhje me udhëzimet ligjore dhe Rregulloren e IAL KUW.</p> <p>Studentët mund të marrin informacion për transferimin nëpërmjet faqes zyrtare të web-it të KUW, njoftimeve të publikuara në stendën e njoftimeve të kolegjit dhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.37. Rregullore e transferimeve Aneksi 1.01. Statuti KUW</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Nga vizita në IAL dhe takimi me studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara qartë në Rregulloren e KUW dhe Rregulloren e Programit të studimit, dokumenta të cilat janë të aksesueshme për studentët e KUW.</p> <p>Gjithashtu, studentët informohen në fillim të çdo semestri në çdo lëndë/modul për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës.</p>

	<p>Edhe Sekretaria Mësimore informon studentët për çështje që kanë lidhje me sekretarinë apo çdo gjë tjetër.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi. Syllabuset e lëndëve Aneksi 3.01. Rregullore e Programit</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ kostanton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në IAL KUË përcaktohen në Rregulloren e programit dhe Rregulloren për mbrojtjen e diplomës, ku përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve BSc mbrohet me provim përfundimtar ose temë diplome në përputhje me kurrikulat mësimore të programeve të studimit. Studentët informohen për këtë nga Departamenti i Ekonomisë, si dhe nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të tretë dhe zgjedhja e temës së punimit (për studentët që presupozohet do zgjedhin të bëjnë punim diplome) bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në IAL KUË, GVJ konstatoi se studentët kishin marrë informacionin e nevojshëm për procesin e diplomimit të tyre.</p> <p>Nga takimi me drejtues të IAL, u konstatua nga GVJ që deri më tani studentët që përfundojnë studimet BSc në Menaxhim Biznesi, diplomën e mbrojnë me provim të përgjithshëm (mbrojnë me temë diplomë studentët që deri në semestrin e pestë kanë mesatare 8.5 e më lart sipas RVB të IAL KUË, por në rregulloren e Departamentit të Ekonomisë specifikohet që studentët mund të japin provim formimi ose të bëjnë punim diplome pa specifikuar notë mesatare). GVJ sugjeron që në Rregulloren e Departamentit të Ekonomisë duhet të bëhen specifikimet e duhura duke shmangur keqkuptimet potenciale (pra nëse duhet një kufi i caktuar për notën mesatare të studimeve për të mbrojtur në fund diplomë).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.12.1. Rregullore mbi standardet, rregullat, mbrojtjes së temave të diplomës Aneksi 3.01. Rregullore e Programit</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW në fillim të çdo viti akademik, në mënyrë periodike përpara se maturanët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e cila bashkëpunon me departamentet e tjera dhe Departamentin e Ekonomisë për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi krahas programeve të tjera. Takimet informuese zhvillohen jo vetëm në mjediset e IAL KUW, por edhe duke vizituar në vend gjimnazet shqiptare. Informimi i publikut bëhet me takime të drejtpërdrejta, në faqen zyrtarë web, njoftimet në stendat e kolegjit,</p>




	<p>nëpërmjet fletë palosjeve, Guidës së Studentit që gjendet në web, rrjeteve sociale, etj. Studentët që potencialisht mund të jenë pjesë e KUW në të ardhmen informohen mbi programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.15. Guida e Studentit</p> <p>Aneksi 3.16. Udhëzues didaktik i Programit Menaxhim Biznesi</p> <p>Aneksi 3.17. Relacion për pjesëmarrjen KU Wisdom në ditët e informimit të maturantëve</p> <p>Aneksi 2.26. Panairi Work & Study</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që informacionet në lidhje me strukturën e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi, organizimin dhe kohëzgjatjen iu vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre. Gjatë vizitës në IAL KUW, GVJ u informua se çdo vit akademik Departamenti i Ekonomisë, krahas departamenteve të tjera, së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve me IAL KUW dhe programin e studimit. Studentët marrin informacion në fillim të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore për orarin, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, etj. Gjithashtu, secili pedagog në prezantimin e lëndës/modulit shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth temave të përfshira, metodës së vlerësimit, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>Informacion në lidhje me këtë program studimi përsa i përket strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së programit, moduleve, lëndëve, përmbajtjes dhe veprimtarive formuese jepet dhe tek Guida e Studentit, që mund të aksesohet në webin zyrtar të IAL KUW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.15. Guida e Studentit (gjendet dhe te faqja web e KUW)</p> <p>Takimi i GVJ me studentët</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se IAL KUW vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet/lëndët, përmbajtjen dhe</p>




<p>posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>veprimtaritë formuese (të cilat janë të përfshira tek planet mësimore dhe të bëra publike për studentët). Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, KUW ofron programin (i zhvilluar në gjuhën shqipe) e studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim biznesi me një kohëzgjatje tre vite dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma Bachelor në Menaxhim biznesi. Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë. Gjithashtu, studentët mund të gjejnë informacion për lëndët/modulet dhe tek syllabuset e lëndëve/moduleve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.16. Udhëzues didaktik i Programit Menaxhim Biznesi Aneksi 3.18. Relacion i ZBNJKKJS për trajnim: Si të realizojmë një aplikim për punë</p> <p>Aneksi. Syllabuset</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>GVJ, nga takimi me studentët dhe Specialisten e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore konstaton se ajo informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe organizon takime dhe trajnime për studentët që i ndihmojnë ata për aplikime të suksesshme për punë. Gjithashtu ekziston dhe një Udhëzues i Karrierës që studentët mund ta aksesojnë në faqen zyrtare të web-it.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, iu jep studentëve informacion rreth mundësive të ndryshme që IAL KUW në bashkëpunim me kompanitë ofron për trajnime, internshipe, mundësi punësimi, etj.</p> <p><i>Sugjerohet që Këshillimi i Karrierës të jetë zyrë në vete, e shkëputur nga zyra e BNj.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.18. Relacion i ZBNJKKJS për trajnim: Si të realizojmë një aplikim për punë</p> <p>Aneksi. Udhëzuesi i karrierës</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë së bashku me dekanatin organizojnë çdo vit takime informuese të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vitin e parë në programin e studimit Bachelor në Menaxhim biznesi në IAL KUW. Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua se studentëve iu jepet një informacion i gjerë dhe i detajuar për aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet, kohëzgjatjen e studimeve, planin mësimor, lëndët/modulet, mënyrat e vlerësimit, etj. Gjatë këtyre takimeve shpjegohen në detaje edhe struktura e IAL KUW, struktura e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, prezantohen drejtuesit, stafi akademik, etj. Informacion jepet në mënyrë të vazhdueshme dhe në faqen web të KUW, në stendat e IAL dhe rrjetet</p>




	sociale.			
	<i>Evidenca:</i> Aneksi. www.wisdom.edu.al Takimi i GVJ me studentët			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacion të detajuar lidhur me programin e studimit studentët marrin nëpërmjet komunikimit në distancë që kanë me pedagogët dhe Sekretarinë Mësimore me anë të Portalit të Studentit (që studentët e aksesojnë te faqja zyrtare web e KUW nëpërmjet përdorimit të username dhe fjalëkalimit përkatës) si dhe nëpërmjet emailve zyrtarë që posedojnë. Informacione të tjera të vlefshme bëhen të mundura nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Jetës studentore, si dhe nëpërmjet botimeve dhe fletëpalosjeve, si dhe informacioneve të tilla si Guida e Studentët të cilën studentët e aksesojnë në faqen web të KUW. Gjatë vitit akademik 2019 – 2020 ku mësimdhënia ishte online, janë përdorur si platforma komunikimi në distancë, platformat Zoom dhe Google Classroom.			
	<i>Evidenca:</i> Aneksi. www.wisdom.edu.al http://portal.hstalb.xyz/ Takimi i GVJ me studentët			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se Zyra e Sekretarisë Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e statistikave vjetore për numrin e studentëve në secilin program studimi, dhe numrin e të diplomuarve përkatës në këto programe studimi. Sekretaria Mësimore i disponon këto statistika (në formë hard copy dhe në mënyrë elektronike), të cilat mbledhen dhe përpunohen në bazë të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015, udhëzimit të MASR nr.9, datë 25.02.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore“, dhe udhëzimit të MASR, nr.16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e IAL Publike dhe Private me Regjistrat Bazë të Studentëve“.
	<i>Evidenca:</i> Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Aneksi 1.07. Rregullore - Sekretaria Mësimore</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u njoh me statistikën që mbante kjo zyrë për programin e studimit Bachelor në Menaxhim biznesi, që përmbanin të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje (<i>të dhënat për mesataret në dalje mungonin?!), të dhëna për të larguarit, transferimet, etj. Konkretisht në programin BSc në Menaxhim biznesi për vitin akademik 2021-2022, janë regjistruar 6 studentë për herë të parë me notën mesatare në hyrje, 7.2; të larguar nuk ka; si dhe 22 transferime studentësh për të treja vitet.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi</p> <p>Aneksi 1.07. Rregullore - Sekretaria Mësimore</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>IAL KUW disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Konkretisht për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, në vitin akademik 2019-2020 janë 9 pranime studentësh, në vitin akademik 2020-2021 janë 15 pranime studentësh, dhe në vitin akademik 2021-2022 janë 6 pranime studentësh; si dhe janë 30 studentë të diplomuar përgjatë v.ak. 2019-2020, dhe 34 studentë të diplomuar përgjatë v.ak. 2020-2021 (numri i diplomuarve është rritur për shkak dhe të transferimeve që ndodhin gjatë viteve të ndërmjetme të studimit).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi</p> <p>Aneksi 1.07. Rregullore - Sekretaria Mësimore</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, e cila synon të ruajë privatësinë dhe këto të dhëna iu vendosen në dispozicion vetëm personave të autorizuar (studentët, pedagogët, drejtuesit e institucionit, etj). Tek sekretaria mësimore gjendet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i notave, regjistri i lëshimit të diplomave, procesverbalet e notave, etj. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë (hard copy) dhe në mënyrë elektronike. Gjatë vizitës në IAL KUW, përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë Mësimore na vunë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi i plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji, si dhe procesverbale notash të lëndëve që përmban programi i studimit BSc në Menaxhim biznesi.</p> <p><i>GVJ konstaton që notat plotësohen manualisht nga pedagogët në procesverbalet përkatëse dhe akoma nuk ka një sistem të mirëfilltë informacioni.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p>





	Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 1.07. Rregullore - Sekretaria Mësimore			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës në IAL KUW, GVJ u informua se departamentet dhe Sekretaria Mësimore hartojnë raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (sipas drejtuesve dhe RVB, cilësia e studentëve në dalje është e barabartë ose më e lartë sesa në hyrje, <i>por në fakt të dhënat për cilësinë në dalje mungojnë?!.</i> Këto analiza dhe raporte që hartohen kryesisht nga Departamentet në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore (e cila kryesisht ndihmon me statistikat) vihen në shërbim të njëjësive dhe drejtuesve të institucionit për të bërë analiza e studime të mëtejshme dhe për të marrë masa përmirësimi në të ardhmen. Gjithashtu, IAL KUW ka realizuar edhe studimin e tregut për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, ndër të tjera për të analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi duke dhënë konkluzione & rekomandime për zhvillimin e programit në të ardhmen. Sipas drejtuesve të IAL KUW, rreth 80-90% e studentëve që përfundojnë studimet në programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, vazhdojnë studimet master. <i>Tabelat me të dhënat e studentëve alumni duhen më të plota, me më shumë informacion, pra duhet më shumë punë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Rrjeti Alumni duhet më i plotë, i mirëfilltë, dhe më i organizuar në aktivitetet që zhvillon IAL për përfitim të dyanshëm. jo thjesht mbajtje kontaktesh të tyre.</i> <i>Evidenca:</i> Aneksi 2.14. Të dhëna tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021 Aneksi 2.39. Tabela: punësim real i studentëve - Evidence Alumni Aneksi 2.09. Studimi Periodik i Tregut i programit Bachelor në Menaxhim Biznesi Aneksi. RVB e IAL KUW			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e	IAL KUW parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas ligjit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>të arsimit të lartë nr. 80/2015 dhe akteve rregullatore të KUW.</p> <p>Në bazë të Statutit të KUW, studentët kanë të drejtë të zgjidhen në: Senatit Akademik – 2 anëtarë; Këshillin studentor; dhe si studentë senatorë sipas grupeve/klasave.</p> <p>Këshilli studentor është organi më i rëndësishëm i studentëve cili përfaqëson dhe mbron interesat studentore, këshill i cili zgjidhet në mënyrë demokratike nga vetë studentët. IAL KUW mbështet këshillin studentor dhe financon veprimtaritë e tij nga fondi i caktuar për këto qëllime nga buxheti vjetor.</p> <p><i>Në RVB te ky kriter duhet më shumë evidencë për studentët pjesëmarrës në komisionet e përhershme apo NJSBC, pra mungojnë vendimet apo procesverbalet përkatëse.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.18.1. Procesverbal për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Studentor</p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW</p> <p>Aneksi 2.24.1.2. Procesverbal për zgjedhjen e studentëve senatorë</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL KUW, në takimim me studentët GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të KUW. Departamenti i Ekonomisë dhe Dekanati i mirëpresin sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe marrëdhënien me IAL KUW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 3.18.1. Procesverbal për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Studentor</p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW</p> <p>Aneksi 2.24.1.2. Procesverbal për zgjedhjen e studentëve senatorë</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>IAL KUW ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim biznesi me një kohëzgjatje tre vite dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS). Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra me nga 15 javë. Fashat e krediteve të aplikuara për lëndët/modulet variojnë nga 4 ECTS në 8 ECTS. Ka një shpërndarje të ekuilibruar ndër vite midis numrit të orëve në auditor plus studimit individual, shpërndarje e cila lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose drejt KUW. Gjatë hartimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi, ngarkesa e akademike është marrë në konsideratë, si dhe është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve apo dhe njohjet e studimeve të mëparshme bëhen në përputhje me Rregulloren e IAL KUW, procedura të cilat janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>

	<p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW</p> <p>Aneksi 3.10.1. Vendim i Departamentit për lëndën Studime Kulturore në Biznes</p> <p>Aneksi 3.04. Planet mësimore tre vitet e fundit</p> <p>Aneksi 3.07. Orari mësimor</p> <p>Aneksi 2.21.2. Ngarkesë mësimore, të gjithë programet</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga takimi me drejtues dhe studentë të IAL KUW, GVJ konstaton se IAL garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Nëpërmjet anëtarëve senatorë të grupeve, anëtarëve të këshillave studentorë, apo studentëve anëtarë të senatit, përcillen kërkesat apo sugjerimet e studentëve në nivelet drejtuese të të gjitha niveleve.</p> <p>Kontribut në përmirësimin e procesit mësimor dhe mbarëvajtjes së programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi janë edhe raportet që nxiren nga NJSBC, nëpërmjet bërjes së takimeve dhe anketimeve të rregullta, dhe më pas përpunimin e pyetësorëve të studentëve (me pyetje të mbyllura dhe të hapura) ku studentët mund të lënë komente sipas këndvështrimit të tyre në ato fusha ku ka nevojë për përmirësime të procesit. Këto raporte diskutohen konkretisht në mbledhjet e Departamentit të Ekonomisë për të marrë masa në lidhje me shqetësimet apo sugjerimet e ngritura nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.19.3. Model Template - Pyetësori i studentëve</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua se atyre iu mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, iu jepet mundësia të vlerësojnë performancën e stafit akademik në të gjitha aspektet e procesit mësimor (që nga procesi i mësimdhënies deri tek mënyrat e vlerësimit të lëndës/modulit). Studentët e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi njihen me rezultatet/pikët e marra gjatë semestrit përpara provimit, dhe me rezultatin e provimit pas zhvillimit të provimit në një afat sa më të shpejtë të mundur. Studentët pohuan se iu jepet e drejta të ankimojnë rezultatin e marrë të provimit, me një kërkesë me shkrim brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit. GVJ i pyeti drejtuesit dhe studentët që a ka patur procedura ankimi nga studentët që kanë kaluar nëpër hallkat drejtuese, por ata thanë që nuk ka patur të tilla; edhe nëse ka patur është zgjidhur që në hallkën e parë nga ballafaqimi me pedagogun përkatës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.02. Rregullore e KUW</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>IAL KUW ka njësi e procedura të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL KUW. Këto njësi janë Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Sekretaria Mësimore, por dhe stafi akademik dhe koordinatorët e programeve të studimit, të cilët janë në shërbim të studentëve dhe ofrojnë informacione të nevojshme sipas funksionit që kryen secila njësi. Studentët informohen gjithashtu dhe nga webi zyrtar i IAL KUW, apo nëpërmjet emaileve zyrtare apo dhe në rrjetet sociale si formë alternative, si dhe mund të përdorin Portalin e Studentit si formë komunikimi interactive me pedagogët e lëndëve/moduleve.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneks 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS Aneksi 1.21. Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore dhe Sekretaria Mësimore asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacione e këshillim për çështje të lidhura me procesin mësimor dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, vendin ku do të kryejnë praktikën, përzgjedhjen e karrierës, etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për këtë program studimi, ku stafi akademik përkatës i ndihmon studentët për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet Portalit të Studentit, faqes zyrtare të web-it dhe Guidës së studentit (e cila gjendet në webin zyrtar).</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneks 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS Aneksi 1.21. Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është njësia që mirëpret studentët duke iu ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me karrierën, praktikën profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Kjo zyrë bashkëpunon në rastin konkret me Departamentin e Ekonomisë për organizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi, organizon panairt e punës, mban marrëdhënie me studentët e diplomuar/alumni, i ofron studentëve mundësi për ndjekjen e shkollave verore, organizon workshop-e/seminare, etj.</p>

	<i>Evidenca:</i> Aneks 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS Aneksi 1.21. Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore në IAL KUW ka si detyrë të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të përgatisë raporte për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre, gjë të cilën në rastin konkret e bën specialistja e Këshillimit të Karrierës. ZBNJKKS nuk ka ndërtuar akoma një databazë të dhënash mbi punësimin e studentëve të programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi (sipas RVB te i njëjti kriter). <i>Sugjerohet që të ndahen veç e veç Zyra e Burimeve Njerëzore me zyrën e Këshillimit të Karrierës & Jetës Studentore. Rregullorja e ZBNJKKJS duhet të përmirësohet, është shumë e shkurtër/e 'thatë'. Duhet më shumë punë nga specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore për të krijuar të dhëna dhe kontakte më të plota (jo thjesht emër, mbiemër, numër telefoni, i punësuar apo jo ...) me studentët e diplomuar/alumni dhe për t'i vënë në funksion të përfitimit të dyfishtë: IAL KUW dhe Studentë alumni, psh. mbajtja më afër e tyre, apo të ftohen në konferenca shkencore të KUW, apo të financojnë projekte të ndryshme të pedagogëve apo studentëve, dhe aktivete të ndryshme studentore.</i>			
	<i>Evidenca:</i> Aneks 1.09. Rregullore e ZBNJKKJS Aneksi 3.18. Relacion i ZBNJKKJS për trajnim - Si të realizojmë një aplikim për punë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje	IAL KUW ka politika dhe struktura për sigurimin e cilësisë, të tilla si Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësinë e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), si struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë të arsimit të lartë, udhëzimet e ASCAL, si dhe aktet rregullatore institucionale. Këto njësi funksionojnë në bazë të Statutit të IAL KUW dhe Rregullores së NJSBC të KUW, njësi të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave & procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneks 2.19. Vendim - Për emërimin e anëtarëve të NJSBC Aneksi 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë Aneksi 2.27. Komisionet e përhershme. - Vendim emërimi Aneksi 1.01. Statuti i KUW</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton që IAL KUW ka ngritur struktura për sigurimin e cilësisë, të tilla si Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC) nëpërmjet të të cilave zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional. NjsBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj. Në këtë njësi është e përfshirë dhe 1 student.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 2.27. Komisionet e përhershme. - Vendim emërimi Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW përdor instrumentat e duhura të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Gjithshtu vlen të theksohet që programi i studimit BSc në Menaxhim biznesi i ofruar nga IAL KUW i është nënshtruar vlerësimit të jashtëm/akreditimit dhe është vlerësuar pozitivisht, me Vendimin nr.158, datë 16.05.2016 të Këshillit të Akreditimit i Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 2.02.1. Vendimi nr.158, datë 16.05.2016 i Këshillit të Akreditimit të APAAL për Akreditimin e Programit</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUW ka hartuar politika dhe procedura periodike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, që synojnë përmirësimin e programeve të studimit që ofron.</p> <p>NJSBC e IAL KUW e ka përqëndruar punën për sigurimin e cilësisë në monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e programeve të studimit si dhe vlerësimin e syllabuseve të lëndëve. Ajo është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe stafit akademik, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetësorët,</p>




	<p>përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj. NJSBC përgatit një raport vjetor në fund vitit akademik në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, raport i cili analizohet në mbledhjet e departamenteve ku merren vendime për ndryshime apo përmirësime të mundshme. Drejtuesit e KUW me strukturat e tyre synojnë krijimin e kulturës së cilësisë të të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC Aneksi 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se IAL KUW ka ngritur një njësi të posaçme: NJSBC, për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit, njësi e cila është përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në njësitë kryesore dhe programet e studimit. Ky vlerësim kryhet në mënyrë periodike duke krijuar raporte, të cilat i dërgohen departamenteve për të marrë vendime për përmirësime të programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu procedura për rishikimin dhe modifikimin e elementëve të programit të studimit mund të fillojë në rastin konkret nga Departamenti i Ekonomisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, ku mund të bëhen ndryshime deri në masën 20% sipas ligjit.</p> <p><i>Sugjerohet që roli i NJSBC të jetë më i madh dhe më i plotë në sugjerimet që jep për departamentet (konstatim i GVJ në takimin me NJSBC).</i></p> <p><i>S'ka dokument bashkëngjitur për ngritjen e komisionit të kurrikulave (a funksionon ky komision). Në RVB duhej (apo duhet) më shumë informacion për Komisionin e Kurrikulave dhe rolin që luan ai.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC Aneksi 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë Aneksi 2.19.2. Plan i veprimtarisë kryesore të NJSBC për vitin 2021-</p>

	<p>2022</p> <p>Aneksi 2.19. Vendim - Për emërimin e anëtarëve të NJSBC</p> <p>Aneksi 2.13. Vendimi i koordinatorit të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ, në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë, përgjegjës për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, u informua se në fillim të çdo viti akademik kërkohen nga stafi akademik mendime apo sugjerime në lidhje me përditësimin e syllabuseve dhe miratohen ndryshimet e mundshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, në përfundim të çdo semestri, Departamenti i Ekonomisë diskuton dhe analizon raportet e krijuara nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve që realizohen nga NJSBC e IAL KUW.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në RVB, të ky kriter duhej të citohej më shumë dhe roli i departamentit në këtë proces, ku ka një rol parësor, normalisht në bashkëpunim me NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit të Studentëve</p> <p>Aneksi 2.42. Relacion Pyetësori i Pedagogëve</p> <p>Aneksi 2.19.6. Relacion i kalendarëve të kontrollit NJSBC</p> <p>Aneksi 2.43. Raporte NJSBC - Studente & Pedagogë</p> <p>Aneksi 2.19.5. Model Template Relacion Semestral i programit të lëndës</p> <p>Aneksi 2.19.3. Model Template: Pyetësori i studentëve</p> <p>Aneksi 2.19.2. Plani i veprimtarisë kryesore të NJSBC për vitin 2021-2022</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>IAL KUW përdor një metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për të parë ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Konkretisht, mekanizmat kryesorë që përdor NJSBC për mbikëqyrjen e programeve të studimit dhe të procesit mësimor janë: pyetësori i studentëve për zhvillimin e mësimin dhe për vlerësimin e kursit, si dhe formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve bëhet mbi një metodologji të caktuar nga NJSBC, ku më pas krijon një raport të cilin ua shpërndan departamenteve. Gjithashtu, organizohen takime (dhe intervista) të përbashketa të NJSBC me pedagogët, studentët, stafin administrativ, etj ku shkëmbehen mendime dhe ide se ku ka nevojë për të bërë përmirësime.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit të Studentëve</p> <p>Aneksi 2.42. Relacion Pyetësori i Pedagogëve</p> <p>Aneksi 2.19.6. Relacion i kalendarëve të kontrollit NJSBC</p> <p>Aneksi 2.43. Raporte NJSBC - Studente & Pedagogë</p>




	Aneksi 2.19.5. Model Template Relacion Semestral i programit të lëndës Aneksi 4.17. Model Template Formular i Vlerësimit të Kapaciteteve Njerëzore në fushën akademike dhe kërkimin shkencor 2017-2021			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e vlerësimeve të NJSBC dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, konkretisht Rektorit & Dekanit & Departamentit përkatës. Në raportet që hartohen jepet informacion mbi problematika të ndryshme të hasura që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre. Në raport përfshihet edhe baza ligjore mbi të cilën mbështetet anketimi i studentëve si dhe metodologjia e hartimit të raportit.			
	<i>Evidenca:</i> Aneks 2.05. Raporti vjetor i KU wisdom për vitin 2020-2021 Aneksi 2.07. Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021 Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit që hartohen nga NJSBC përfshijnë vlerësimin e situatës, kryesisht të gjërave që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe jepen rekomandimet/masat që duhen marrë nga departamentet apo njësitë përkatëse të tjera për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e elementëve të duhura që nuk janë siç duhet. Nga ana tjetër, edhe Departamentet bëjnë analizën e tyre vjetore dhe hartojnë një raport me të gjithë elementët përkatës, duke përfshirë stafin akademik, strukturën mësimore, studentët, bashkëpunimin me IAL të tjera dhe më njësi të tjera në KUW, etj, si dhe vendosen objektivat për të ardhmen.			
	<i>Evidenca:</i> Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021 Aneks 2.05. Raporti vjetor i KU Wisdom për vitin 2020-2021 Aneksi 2.07. Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program	GVJ konstaton se IAL KUW kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit nëpërmjet NJSBC. Gjatë vitit akademik NJSBC realizon vlerësime duke e bazuar kryesisht raportimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>në analizën e pyetësorëve të studentëve për procesin mësimor për çdo semestër mësimi. Këto raporte janë pjesë e RVB edhe për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim biznesi që po trajtohet në këtë Raport të Vlerësimit të Jashtëm. Departamentet i përdorin këto raporte të NJSBC në kuadër të akreditimeve apo dhe të vlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë Aneksi 2.05. Raporti vjetor i KU Wisdom për vitin 2020-2021 Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021 Aneksi 2.19.6. Relacioni i kalendarëve të kontrollit NJSBC Aneksi 2.19.5. Model template - Relacion Semestral i programit të lëndës</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, NJSBC përdor instrumenta të ndryshëm (të tillë si pyetësorë për studentët; pyetësorë për pedagogët; takimet e përbashkëta me pedagogët dhe departamentet; intervista me studentët; takime me stafin administrativ, etj) për vlerësimin e cilësisë së programit dhe mbarëvajtjes së tij, instrumenta të drejtpërdrejta ose të tërthorta në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Gjithashtu, edhe Departamenti i Ekonomisë bën analizën vjetore të tij për çdo vit akademik ku trajton me detaje ecurinë e programeve të tij të studimit dhe përmirësimet potenciale në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.42. Relacion - Pyetësori Pedagogëve Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit të Studentëve Aneksi 2.19.6. Relacioni i kalendarëve të kontrollit NJSBC Aneksi 2.43. Raporte NJSBC - Studente & Pedagogë Aneksi 2.19.5. Model template - Relacion Semestral i programit të lëndës Aneksi 2.12. Analiza vjetore e Departamentit të Ekonomisë 2020-2021 Aneksi 4.01. Raport Vjetor i Njësise së Kërkimit Shkencor dhe Marredhënieve me Jashtë 2020-2021 Aneksi 4.17. Model Template Formulari i Vlerësimit të Kapaciteteve Njerezore në fushën akademike dhe kërkimin shkencor 2017-2021</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për</p>	<p>NJSBC realizon vlerësimin e programit të studimit, të planeve mësimore, të syllabuseve në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve/moduleve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik për stafin akademik, ngarkesën e orëve për studentët, vlerësimin e materialeve didaktive, etj. Bëhet vlerësimi i performancës së stafit akademik nëpërmjet të cilit vlerësohen hartimi i leksioneve të reja, përditësimi i syllabusit dhe literaturës, niveli i kërkimit shkencor, etj. Instrumenta të tjera janë edhe monitorime të drejtpërdrejta gjatë procesit të mësimin, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj.</p>



<p>profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.42. Relacion - Pyetesori Pedagogëve Aneksi 2.16. Model Template Test Provimi Përfundimtar Aneksi 2.16.1. Model Template Test provimi i Ndërmjetëm Aneksi 2.16.2. Model i formularit të vlerësimit të vazhdueshem të studentit Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit te Studentëve Aneksi 2.19.6. Relacion i kalendareve të kontrollit NJSBC Aneksi 2.43. Raporte NJSBC - Studente & Pedagogë Aneksi 2.19.5. Model template - Relacion Semestral i programit të lëndës</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>NJSBC kryen gjithashtu sondazhe dhe intervista me studentët dhe takime me pedagogët e programit të studimit në lidhje me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mundësitë potenciale për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi. Bëhen takime dhe me stafin ndihmës akademik dhe administrativ (si punonjës të vijës së parë që janë më në kontakt me studentët) të IAL në mënyrë që mendimet e tyre të reflektohen në vendimmarrjet e ardhshme nga ana e drejtuesve në IAL KUW.</p> <p><i>GVJ sugjeron që t'i jepet një rëndësi e veçantë edhe anketimit të të diplomuarve/alumni të këtij programi studimi nga ana e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, për të vlerësuar përpunjen e kurrikulës me nevojat e tregut dhe përshtatjen e studentëve të këtij programi me njohuritë që kanë marrë në tregun e punës.</i></p> <p><i>Pyetësorët duhet të realizohen gjithashtu dhe për stafin ndihmës akademik dhe atë administrativ, sepse dhe ata ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.42. Relacion - Pyetesori Pedagogëve Aneksi 2.41. Relacione të Pyetësorit të Studentëve Aneksi 2.19.5. Model Template - Relacion Semestral i programit të lëndës Aneksi 2.19.6. Relacion i kalendareve të kontrollit NJSBC</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni duhet të</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga informacionet e marra</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>gjatë vizitës në IAL KUW, GVJ konstaton përfshirjen e aktorëve të brendshëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në strukturën e NJSBC janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njëjve kryesore dhe përfaqësues të studentëve, por <i>sugjerohet që të përfshihet dhe një ekspert i jashtëm</i>. Gjithashtu, për vlerësimin e brendshëm ngrihen grupe pune me staf akademik, por duke përfshirë dhe përfaqësues të studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneks 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë Aneksi 1.03. Plani Strategjik i zhvillimit të KUW Aneksi 2.03. Vendimi i Rektorit të KU Wisdom - Për krijimin e Komisionit për Vlerësimin e brendshëm për Akreditimin Aneksi 1.11. Rregullore e Komisionit të GSC</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në IAL KUW, për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur NJSBC, ku detyrat dhe përgjegjësitë e saj konkrete janë të përcaktuara në Statutin e KUW, rregulloren e KUW.</p> <p>NJSBC bashkëpunon me departamentet dhe me njësitë e tjera në mënyrë të vazhdueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu dhe ZBNJKKS ka rolin e saj të rëndësishëm me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara në ligj dhe rregulloret e KUW.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.01. Statuti i KUW Aneksi 1.02. Rregullore e KUW Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC Aneksi 1.11. Rregullore e Komisionit të GSC</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga hulumtumi i dokumentave dhe takimi me drejtues të IAL KUW, shihet se ai garanton përfshirjen e drejtpërdrejtë të njësisë bazë (departamentit të ekonomisë) dhe asaj kryesore (dekanati) përgjegjëse për programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi, të personelit administrativ, si dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, nëpërmjet strukturës së NJSBC. Gjithashtu në porcesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi janë të përfshirë edhe stafi akademik, të cilët me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre, kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneks 2.03. Vendimi i Rektorit të KU Wisdom - Për krijimin e Komisionit për Vlerësimin e brendshëm për Akreditimin</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi, GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektur integritetin akademik dhe kanë</p>

kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Sipas tyre, gjatë zhvillimit të pyetësorëve është ruajtur anonimati dhe integriteti akademik, si dhe duke respektuar parimet e etikës, të cilat janë të detyrueshme për tu ndjekur për të gjithë palët e përfshira.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.03. Plani Strategjik i zhvillimit K UW Aneksi 1.06. Rregullore e NJSBC</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.</p>	<p>Nga IAL K UW është krijuar një bord këshillimor biznesi me synimin që mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij, si dhe për të ndihmuar studentët në zhvillimin e praktikave.</p> <p>Bazuar dhe në dokumentacionin përkatës, është gjithë e mirë që është krijuar ky bord që në vitin 2019, por <i>GVJ mendon që kontributi i tyre duhet të jetë më i madh ose të pasqyrohet më saktë veprimtaria e tyre dhe e dokumentuar tek RVB, si dhe të shihet mundësia e përfshirjes si ekspertë të jashtëm dhe ish të diplomuar/alumni që janë të suksesshëm në punën e tyre dhe që e njohin mirë këtë fushë.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneks 2.25. Vendim Bordi këshillimor i biznesit Aneksi 2.25.1. Bordi Këshillimor i Biznesit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC se kjo njësi i bën transparente dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve në IAL K UW (personelit akademik dhe studentëve) politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Informacioni përcillet në institucion nëpërmjet departamenteve tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare apo raporteve të hartuara nga NJSBC. Gjithashtu këto raporte bëhen publike dhe në faqen zyrtare të IAL: www.wisdom.edu.al.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.19.7. Politika për garantimin e cilësisë</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin</p>	<p>IAL K UW i publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që NJSBC realizon, dhe i shpërndan në të gjitha nivelet brenda institucionit. GVJ konstaton se publikimi i të gjitha dokumentave dhe informacioneve</p>

<p>për të dhënat personale.</p>	<p>bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që NJSBC i analizon rezultatet e vlerësimit, dhe në bazë të këtyre rezultateve ajo ka nxjerrë konkluzione dhe ka dhënë rekomandime/plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive që janë eventuar.</p> <p>Gjatë takimit me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë, si dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, GVJ u informua se raportet e NJSBC analizohen në mbledhjet e departamentit dhe dekanatit, dhe merren masa për zgjidhjen e tyre sipas rastit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.15. Raport vjetor i monitorimit të cilësisë Aneksi 2.19.2. Plani i veprimtarisë kryesore të NJSBC për vitin 2021-2022</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se NJSBC monitoron dhe vlerëson cilësinë nëpërmjet mekanizmave të saj, ndërsa dekanatet dhe departamentet luajnë një rol kyç në kontrollin e zbatimit të masave të marra dhe analizojnë ndikimin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë duke përfshirë në rastin konkret dhe programin e studimit BSc në Menaxhim biznesi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.03. Plani Strategjik i zhvillimit të KUW Aneksi 2.05. Raporti Vjetor i KU Wisdom për vitin 2020-2021 Aneksi 2.07. Analiza Vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë, GVJ u informua se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit BSc në Menaxhim biznesi. Bëhen mbledhje periodike dhe të vazhdueshme të departamentit apo dekanatit (në raste të caktuara dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve) me qëllim diskutimin mbi problematika të ndryshme mbi ecurinë e procesit mësimor apo çështje të tjera të ngjashme, si dhe adresimin e tyre për zgjidhje nga strukturat përgjegjëse përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2.43. Raporte NJSBC – Studentë & Pedagogë Aneksi. Takimi në IAL KUW</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim biznesi" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar Wisdom"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Akses i bibliotekës online. Mbështetja e pedagogëve dhe studentëve në aksesimin e bibliotekës online ProQuest për mbarëvatjen e mësimin dhe punën kërkimore shkencore.
2. Staf akademik. Programi i studimit BSc në Menaxhim biznesi mbulohet nga një staf akademik në pjesën më të madhe i mirë i kualifikuar dhe me eksperiencë në mësimdhënie.
3. Metodave të mësimdhënies. Institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies duke zhvilluar vazhdimisht seminare/trajnime për personelin akademik dhe duke përdorur metoda me në qendër studentin.
4. Mbështetja e studentëve. Institucioni mbështet studentët në të gjithë procesin e shkollimit, që nga hyrja deri në dalje nën kujdesin e koordinatorit të programit dhe stafit të Departamentit të Ekonomisë të cilët gjenden gjithmonë pranë studentëve.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e një raporti audit ligjor të pavaruar që vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të IAL, dhe ku të paraqiteshin në mënyrë të hollësishme analiza në lidhje me të ardhurat dhe kostot për studentët duke argumentuar edhe përputhjen e performancës financiare të KUW në lidhje me standardet kontabël të miratuara (në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, KUW dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron).
2. Disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc (e mira do të ishte që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.). Por GVJ e ka marrë në konsideratë faktin që prej gati 10 vitesh në Shqipëri nuk janë regjistruar kandidatë të rinj për doktoratura dhe për shumë vite është bllokuar edhe dhënia e titujve shkencorë.
3. Nuk ka një sistem të mirëfilltë informacioni & menaxhimi (notat plotësohen manualisht nga pedagogët në procesverbalet përkatëse, jo nga sistemi). Konstatohet që mungon një platformë standarde e-learning.
4. Staf akademik përgjegjës për programin e studimit ka një angazhim të ulët në pjesëmarrje në konferenca apo botime shkencore.

Rekomandime:

1. Duke qenë se disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc, në të ardhmen sugjerohet që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.
2. Përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka e IAL KUW, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave në të ardhmen për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë. Pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e



titujve të librave fizikë për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Menaxhim biznesi. Si dhe numri i kompjuterave/laptopëve në bibliotekë është i vogël dhe sugjerohet *shtimi i kompjuterave/laptopëve* për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.

3. Sugjerohet që të ndahen *veç e veç Zyra e Burimeve Njerëzore me zyrën e Këshillimit të Karrierës & Jetës Studentore. Rregullorja e ZBNJKKS* duhet të përmirësohet ... është *shumë e shkurtër/e thatë*. Duhet më shumë punë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore për të *krijuar të dhëna dhe kontakte më të plota, të mirëfillta, e të organizuara* (jo thjesht emër, mbiemër, numër telefoni, i punësuar apo jo ...) me studentët e *diplomuar/alumni* dhe për t'i vënë në funksion të përfitimit të dyfishtë: IAL KUW dhe Studentë alumni, psh. mbajtja më afër e tyre, apo të flohen në konferenca shkencore të KUW, apo të financojnë projekte të ndryshme të pedagogëve apo studentëve, dhe aktivete të ndryshme studentore. GVJ sugjeron që t'i jepet një rëndësi e veçantë edhe *anketimit të të diplomuarve/alumni të këtij programi studimi nga ana e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, për të vlerësuar përputhjen e kurrikulës me nevojat e tregut dhe përshtatjen e studentëve të këtij programi me njohuritë që kanë marrë në tregun e punës. Pyetësorët duhet të realizohen gjithashtu dhe për stafin ndihmës akademik dhe atë administrativ, sepse dhe ata ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies.*
4. Në faqen *web* të IAL KUW të përfshihet më *shumë informacion për stafin akademik* (informacion i cili mungon) të përfshirë në programin e studimit, *bashkë me CV-të e tyre*, gjë që tregon transparencë. Sugjerohet që të *publikohen të gjitha dokumentat zyrtare* (rregullore, etj) në faqen web të IAL KUW.
5. Duhet më shumë *angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore*. Ekziston vendimi nga administratori i shoqërisë për financimin e punimeve shkencore të pedagogëve & pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore apo trajnime, por konkretisht dhe praktikisht duhet më shumë informacion mbi materializimin (aplikimin në praktikë) dhe nxitje nga drejtuesit (por dhe stafi që të përdoren këto fonde të alokuara) për zbatimin në praktikë të vendimit të administratores për ide konkrete, inovative të studentëve, etj.
6. Sugjerim që tek *auditorët të mbyllet pjesa lart e mureve (janë të hapura)* sepse krijon probleme/konfuzion/zhurma kur zhvillohet mësim në shumë salla njëkohësisht.
7. Nga vëzhgimi i dokumentave, kriteret nuk parashikojnë regjistrimin e studentëve të huaj, apo të trojeve, apo me aftësi të kufizuara & me status jetimi, gjë që sipas mendimit të GVJ duhet të parashikohen në të ardhmen (konstatohet që ky kriter është keqkuptuar nga GVB në përgjigjen që ka dhënë).
8. Në përfundim të provimit të formimit (ose mbrojtjes së diplomës), studentët vlerësohen me notë nga 4-10 (sipas RVB, standardi III.8, kriteri 7 ... kjo gjë duhet të specifikohet më qartë dhe në rregulloren përkatëse të Departamentit të Ekonomisë?!).
9. Sugjerohet që *roli i NJSBC të jetë më i madh dhe më i plotë* në sugjerimet që jep për departamentet (konstatim i GVJ në takimin me NJSBC). S'ka dokument bashkëngjitur për *ngritjen e komisionit të kurrikulave* (a funksionon ky komision). Në RVB duhej më shumë informacion për Komisionin e Kurrikulave dhe rolin që luan ai. Në RVB duhej të citohej më shumë dhe roli i departamentit në këtë proces, ku ka një rol parësor ... normalisht në bashkëpunim me NJSBC. Si dhe është krijuar një bord këshillimor biznesi që në vitin 2019, por GVJ mendon që kontributi i tyre duhet të jetë më i madh ose të pasqyrohej më saktë veprimtaria e tyre dhe e dokumentuar tek RVB ... si dhe të shihet mundësia e përfshirjes si


ekspertë të jashtëm dhe ish të diplomuar/alumni që janë të suksesshëm në punën e tyre dhe që e njohin mirë këtë fushë. Si dhe në strukturën e NJSBC janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njësisë kryesore dhe përfaqësues të studentëve, por sugjerohet që të përfshihet dhe një ekspert i jashtëm.

10. GVJ mendon se duhet të kishte më shumë marrëveshje të tilla bashkëpunimi me IAL, sidomos ato të huaja për shkëmbime studentësh, pedagogësh, etj.
11. CV e stafit akademik duheshin më të plota dhe më të unifikuara si format (psh., disa janë në gjuhën shqipe, disa në gjuhën angleze, etj). Si dhe, tek RVB, kjo pikë duhej plotësuar më plotë nga ana e grupit të punës.
12. Syllabuset duhet të ishin më të plota, konkretisht te syllabuset e lëndëve/moduleve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhim strategjik & Biznes dhe marketing ndërkombëtar & Teknologji informacioni (lëndë të zhvilluara në module), mungesa e informacionit (dmth të paplota) për pjesën/modulin e Menaxhimit të burimeve njerëzore & Marketingun ndërkombëtar & Menaxhimin e sistemeve të informacionit.
13. Duhej e formalizuar me vendim për studentët pjesëmarrës në komisionet e përhershme apo NJSBC, apo për mbrojtjen e diplomës nga studentët me notë mesatare 8.5 e lart (në rregulloren e Departamentit të Ekonomisë specifikohet që studentët mund të japin provim formimi ose të bëjnë punim diplome), si dhe që rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore është e paplotë ... mungojnë faqe. Të dhënat në për mesataret në dalje mungonin.
14. Duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Ekziston vendimi nga administratori i shoqërisë për financimin e punimeve shkencore të pedagogëve & pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore apo trajnime, por konkretisht dhe praktikisht duhet më shumë informacion mbi materializimin (aplikimin në praktikë) dhe nxitje nga drejtuesit (por dhe stafi që të përdoren këto fonde të alokuara) për zbatimin në praktikë të vendimit të administatorës për ide konkrete, inovative të studentëve, etj.

Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “Business Management” of the Higher Education Institution “Wisdom University College”

Strengths and affirmations:

1. Online library access. Supporting faculty staff and students in accessing the ProQuest online library regarding learning process and research.
2. Academic staff. The BSc study program in Business Management is covered for the most part by a well-qualified and experienced academic staff in teaching.
3. Teaching methods. The institution has paid special attention to the use of various innovative teaching methods by continuously conducting seminars/trainings for academic staff and by using student-centered methods.



4. Student support. The institution supports students throughout the schooling process, from entry to exit under the care of the program coordinator and the staff of the Department of Economics who are always close to the students.

Weaknesses:

1. Lack of an independent legal audit report that assesses and documents the financial condition of HEI, and where to present in detail the analysis regarding income and costs for students arguing the compliance of financial performance of K UW in relation to accounting standards approved (based on the documentation made available, K UW documents annual financial reports at the institutional level, and not detailed for the specific study programs it offers).
2. Some of the course/module academic staff have the MSc degree (it would be good if the course/module academic staff have at least the scientific degree PhD). But the EEG (external evaluation group) has taken into consideration the fact that for almost 10 years in Albania no new candidates for doctorates have been registered and for many years the awarding of scientific titles has been blocked.
3. There is no proper information & management system (grades are completed manually by professors in the relevant forms, not by the system). It is found that a standard e-learning platform is missing.
4. The academic staff responsible for the study program has a low commitment to participation in conferences or scientific publications.

Recommendations:

1. Since some of the course/module academic staff have the MSc degree, in the future it is suggested for the course/module academic staff to hold at least the PhD scientific degree.
2. Regarding the physical spaces offered by the HEI K UW library, EEG (External Evaluation Group) suggests adding spaces in the future to enable a larger number of students to access its resources at the same time. Although the institution has made considerable efforts (and plans) to add literature to the library, there is still need for adding physical textbooks to support the needs of the Bachelor of Business Administration program. The number of computers/laptops in the library is small and it is suggested to add computers/laptops to better serve the navigation of students in the online sources of literature.
3. It is suggested that the Human Resources Office to be separated from the Career & Student Life Counseling Office. The regulation of the *HRC SLCO* needs to be improved ... it is too short. More work is needed from the Career and Student Life Counseling specialist to create more complete, genuine, and organized data and contacts (not just name, surname, telephone number, employed or not ...) with graduate students/alumni and to put them in the function of double benefit: IAL K UW and Alumni Students, e.g. keep them closer, or be invited to K UW scientific conferences, or by funding various projects of professors or students, and various student activities. EEG suggests that special attention be given to the survey of graduates/alumni of this study program by the Career Counseling Office, to assess the compliance of the curriculum with the market needs and the adaptation of students of this program with the knowledge they have acquired in the labor market. Questionnaires should also be completed for academic support staff and administrative staff, as they also affect the smooth running of the teaching process.
4. The website of HEI K UW should include more information about the academic staff (information which is missing) included in the study program, together with their CVs, which



shows transparency. It is suggested to publish all official documents (regulations, etc.) on the website of HEI KUW.

5. More practical, real commitment and promotion from the HEI is needed for the academic staff for various publications in prestigious foreign scientific journals and participation in scientific conferences. There is a decision by the administrator of the company to finance the scientific works of professors & their participation in scientific conferences or trainings, but concretely and practically it is needed more information on 'materialization' (application in practice) and encouragement from managers (but also staff to use these allocated funds) for the practical implementation of the administrator's decision for concrete, innovative student ideas, etc.
6. It is suggested regarding auditors to close the upper part of the walls (they are opened) because it creates problems / confusion / noise when teaching takes place in many auditoriums at the same time.
7. From the observation of the documents, the criteria do not foresee the enrollment of foreign students, or 'të trojeve' (in albanian language), or with disabilities & orphan status, which in the opinion of the EEG should be foreseen in the future (it is concluded that this criterion is misunderstood by IEG (internal evaluation group) in the answer they gave).
8. At the end of the final exam (or diploma), students are evaluated with a grade of 4-10 (according to IER, III.8 standard, criterion 7 ... this should be specified more clearly in the relevant regulation of the Department of Economics).
9. It is suggested that the role of the IQAU to be greater and more complete in the suggestions it gives to the departments (observation of the EEG in the meeting with the IQAU). There is no attached document for the establishment of the Curriculum Commission (does this commission functions). The IER needed more information about the Curriculum Commission and the role it plays. The role of the department in this process should have been cited more in the IER, where it has a primary role ... normally in cooperation with the IQAU. As a business advisory board has been established since 2019, but EEG thinks that their contribution should be greater or to reflect more accurately their activity and documented in the IER ... as well as to see the possibility of involvement as external experts, former graduates/alumni who are successful in their work and who are well acquainted with the field. Representatives of the main units and student representatives are included in the structure of the IQAU, but it is suggested the involvement of an external expert.
10. EEG thinks that there should be more cooperation agreements with HEIs, especially foreign ones for exchanges of students, professors, etc.
11. The CV of the academic staff needed to be more complete and more unified as formats (eg, some are in Albanian, some in English, etc.). Also, in the SER, this point had to be completed more fully by the working group.
12. Syllabuses should be more complete, specifically in the syllabi of courses / modules: Human resource management and Strategic Management & Business and international marketing & Information technology (courses developed in modules), lack of information (ie incomplete) for part / module of Human Resources Management & International Marketing & Information Systems Management.
13. It had to be formalized students participating in the standing committees or NJSBC, or for the defense of the diploma from students with a grade point average of 8.5 and above (the regulation of the Department of Economics specifies that students can take the formation



exam or do a diploma thesis), as well as that the regulation of the Faculty of Economic and Social Sciences is incomplete ... pages are missing. Data on output averages were missing.

14. More practical, real commitment and promotion from the HEI is needed for the academic staff for various publications in prestigious foreign scientific journals and participation in scientific conferences. There is a decision by the administrator of the company to finance the scientific work of professors & their participation in scientific conferences or trainings, but concretely and practically we need more information on materialization (application in practice) and encouragement from managers (but also staff to use these allocated funds) for the practical implementation of the decision of the administrator for concrete, innovative ideas of students, etc



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	